



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21 regjistër (JR)  
Datë 18.10.2018

Nr. 2 i vendimit  
Datë 04.02.2019

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 04.02.2019, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli, gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 62, 63, 64, 65, 66 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni F i Aneksit të Kushtetutës, neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 41, datë 18.07.2018, ka vendosur:
  - o *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.*
  - o *Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare në internet të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
  - o *Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.*
  - o *Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), pasi ka filluar *ex officio* procesin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, ka zhvilluar seancën dëgjimore publike dhe pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha provat e administruara, si dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimet e mëposhtme.

(i) Sa i përket kriterit të vlerësimit të figurës, në përmbledhje Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, duke mos plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi dhe duke fshehur fakte e rrethana të ndodhura para deklaramit sipas ligjit të këtij formulari. Ai ka bërë edhe deklaram të pasaktë, bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e germës “g” të kreut V “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

(ii) Sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, sipas parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe ka kryer deklaram të rremë në deklaramtën “vetting” për burimin e krijimit të këtyre pasurive.

(iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.

2. Kundër vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit, brenda afatit ligjor, rezulton të jetë ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli (në vijim subjekti). Ankimi rezultoi i plotë në elementet procedurale, si të formës, edhe të përmbajtjes. Për rrjedhojë, Komisioni me vendimin e tij nr. 5, datë 16.10.2018, ka vendosur: *Pranimin e ankimit të datës 03.10.2018, me*

*nr. 5353/4 prot., të paraqitur nga subjekti, si ankim i plotë dhe në përputhje me nenin nr. 46 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".*

## **II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit duke paraqitur shkaqet ankimore të mëposhtme.

3. Subjekti pretendon se vlerësimi i pasurisë nuk ka kufizim në kohë, ndryshe nga vlerësimi i figurës dhe ai profesional, por gjithsesi është i lidhur ngushtë me funksionin e gjyqtarit. Shumica e pasurive mbi të cilat ka gjetur parregullsitë Komisioni, janë krijuar në pjesën më të madhe gjatë ushtrimit të profesionit të ligjshëm si avokat dhe jo gjatë ushtrimit të profesionit si gjyqtar.
4. Sipas subjektit, hetimi i trupit gjykues në Komision nuk ka qenë i thellë dhe i gjithanshëm, pasi atij nuk i janë përfshirë dhe as njoftuar rezultatet lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti pretendon se trupi gjykues i Komisionit ka paragjykuar çështjen duke mos dhënë argumente përse nuk e ka pranuar kërkesën për t'u njohur me rezultatet e hetimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, me arsyetimin e vetëm se subjekti nuk arriti me provat dhe shpjegimet e paraqitura të provojë të kundërtën.
5. Gjithashtu, subjekti pretendon se lidhur me hetimin në Komision, nuk janë shqyrtuar argumentet dhe kundërshtimet e subjektit për pagesat e pasurive me këste, çka është ndër pikat më themelore të mbrojtjes.
6. Subjekti pretendon se vlerësimi i trupit gjykues të Komisionit është i pasaktë dhe i pavërtetë. Procesi i rivlerësimit nuk ka qenë i paanshëm, pasi është kryer një hetim sekret dhe jo i mirëfilltë. Provat që janë mbledhur kryesisht, në mënyrë të njëanshme, e që janë të papërsëritshme nuk i janë njoftuar subjektit. Subjekti ka të drejtën të njihet me të gjitha provat e grumbulluara, pavarësisht nga përfshirja e tyre në proces.
7. Një tjetër shkak ankimor është se trupi gjykues i Komisionit, sipas subjektit, mbi të njëjtat prova të paraqitura nga ana e subjektit për pasuritë, pa dhënë asnjë arsye, ka arritur në konkluzion të kundërt me hetimin e kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë ILDKPKI). Nga ana tjetër, lidhur me raportin fillestar të DSIK, relatorja dhe shumica në vend që të arsyetonin dhe të kryenin hetimin e tyre të gjithanshëm, i kërkojnë DSIK-së të rishikojë raportin. Me këto veprime, është shkelur neni 253 i Kodit të Procedurës Civile për provueshmërinë e plotë të shkresave zyrtare.
8. **Lidhur me konkluzionet e trupit gjykues të Komisionit për kontrollin e kriterit të figurës,** subjekti ka parashtruar në ankim shkaqet si vijojnë:

**8.1** Gjetja që i ka rezultuar Komisionit, në lidhje me revokimin e vizës nga Ambasada e ShBA-së në Shqipëri, nuk është e sqaruar se në ç'mënyrë ka afektuar kriterin e kontrollit të figurës, pa përmendur rrethanat nga ana e Komisionit me qëllim që të pengojë mbrojtjen efektive nga ana e subjektit. Kështu subjektit i është njoftuar një konkluzion i përgjithshëm dhe i padetajuar, duke bërë një shtrembërim të fakteve të cilat nuk qenë parashtruar në rezultatet e hetimit lidhur me kontrollin e figurës. Gjithashtu, mungon raporti i shkakësisë midis kësaj gjetjeje dhe objektit të kontrollit të figurës, në një kohë që DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve, subjektit i është mohuar e drejta e një mbrojtjeje efektive, pasi nuk i janë paraqitur në kohë detajet e nevojshme të kësaj gjetjeje.

8.2. Faktet në lidhje me gjetjen që i përkasin revokimit të vizës B/2 nga Ambasada e ShBA-së në Shqipëri, i janë njoftuar subjektit për herë të parë pas zbardhjes së vendimit, duke shtrembëruar kështu faktet dhe duke i shtuar për herë të parë në vendimin përfundimtar, çka përbën anashkalim të parimeve themeltare të një procesi të drejtë administrativ, civil, penal apo kushtetues.

8.3 Shumica e trupit gjykues në Komision nuk ka bërë një analizë ligjore për të përcaktuar nëse koncepti i refuzimit të hyrjes është i njëjtë me konceptin e revokimit të vizës. Revokimi i vizës dhe refuzimi i hyrjes janë koncepte krejtësisht të ndryshme, të cilat nuk përbëjnë të njëjtën gjë. Refuzimi i hyrjes është një instrument në politikën e emigracionit të ShBA-së dhe është një masë administrative ose gjyqësore, e cila u jepet të huajve të cilët janë subjekt deportimi në Amerikë. Ndërsa revokimi i vizës është një institut tjetër ndaj personave që shpallen *non-grata* dhe u përcaktohet shkaku dhe afati i ndalimit. Ndërsa në rastin konkret, konsullata i konfirmon poseduesit të vizës se ka të drejtë të aplikojë për një vizë tjetër, çka nënkupton se ndaj tij nuk ka një ndalim hyrjeje.

8.4 Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse i referohemi pyetjes së pjesës 5, germa “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, e cila përmban tekstin: “Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?” - periudha e deklarimit janë 10 vitet e fundit, ndërsa afati për deklarimin e këtyre fakteve është 30 ditë nga hyrja në fuqi e ligjit. Ligji ka hyrë në fuqi më datë 08.10.2016. Nga kjo rrjedh se periudha për të cilën duhen deklaruar faktet është 08.10.2006 deri në datën 08.10.2016, brenda 30 ditëve nga hyrja e ligjit në fuqi. Ndaj revokimi i vizës në datën 26.01.2017 ka ndodhur jashtë periudhës së parashikimit ligjor për t’iu përgjigjur kërkesave të formularit të kontrollit të figurës.

8.5 Përfundimi i shumicës së trupit gjykues në Komision lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, është krejtësisht i paarsyeshëm, në shkelje të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe shkelje flagrante e nenit 38, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Pasaktësia e deklarimit nuk konkurren me fshehjen e fakteve dhe është në kundërshtim me parashikimet e normave kushtetuese, pasi njëri koncept përjashton tjetrin.

8.6 Lidhur me pamjaftueshmërinë e deklarimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në përfundimin e shumicës së trupit gjykues në Komision, rezulton se nuk është konstatuar asnjëherë dhe nuk i është njoftuar subjektit kjo pamjaftueshmëri në deklarim. Në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës nuk ka asnjë vend bosh dhe të paplotësuar, çka trupi gjykues e ka pasqyruar edhe në vendimin përfundimtar në pikën 1.4, ku shprehet se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli e ka paraqitur të plotësuar formularin për kontrollin e figurës.

9. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, subjekti pretendon se Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka përcaktuar se ILDKPKI-ja ka kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës në përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklarimit. Sipas tij, shumica e trupit gjykues në Komision ka shkelur nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim KPC) duke përmbysur provat e paraqitura nga ILDKPKI-ja, pa arsyetuar veprimin e tyre. Kjo duhej të ndodhte në rastet kur hetimi i ILDKPKI-së nuk do të ishte i plotë dhe i saktë.

10. **Lidhur me pasurinë**, banesë me sipërfaqe 260 m<sup>2</sup> dhe 300 m<sup>2</sup> oborr, me vendndodhje te {\*\*\*}, Rruga {\*\*\*}, nr. 64, Tiranë, subjekti ka paraqitur në ankim pretendimet si vijojnë:

10.1 Shumica e trupit gjykues të Komisionit ka bërë një konstatim të gabuar të fakteve sipas të cilit “çmimi është paguar totalisht nga subjekti i rivlerësimit”, konstatim i cili nuk është korrekt, pasi nuk ka vlerësuar nenin 6 të kontratës së sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2007. Në të parashikohet se porositësi është i detyruar të paguajë çmimin e përcaktuar në kontratë, sipas së cilës, në rast të mospagimit në kohë të tij, porositësi do t’i

paguajë sipërmarrësit një kamatëvonesë prej 500 eurosh për vonesat deri në 30 ditë, çka tregon që pagesa nuk ka qenë e menjëhershme.

**10.2** Shumica e trupit gjykues në Komision ka konstatuar gabim faktin se në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti nuk ka deklaruar detyrimin financiar ndaj shoqërisë ndërtuese {\*\*\*}SHPK. Subjekti si detyrim financiar i referohet detyrimit ndaj bankës në të cilën ka marrë kredi për qëllimin e pagimit të ndërtimit, sipas kontratës së lidhur me {\*\*\*}SHPK, por realisht nuk ka pasur asnjë pagesë nga ana e z. G.S., ndaj dhe nuk ka detyrim konkret ndaj tij. Detyrimi është ndaj bankës, e cila ka disbursuar kredinë në shumën 150.000 euro sipas kontratës së lidhur me Raiffeisen Bank.

**10.3** Shumica e trupit gjykues në Komision nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për sa kohë nuk janë krijuar elementet e nevojshme që kërkon kjo dispozitë kushtetuese, kalimi i barrës së provës është antikushtetues. Si rrjedhojë, është e nevojshme prania e elementeve faktike që plotësojnë shkaku e përpjekjeve për të fshehur pasurinë në pronësi, posedim apo përdorim, si dhe shkaku e përpjekjeve për ta paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri. Ndaj prezumimi në favor të masës disiplinore dhe kalimi i barrës së provës është i pavlefshëm, për sa kohë nuk janë identifikuar sjelljet e subjektit për të bërë deklaratimet e pasakta, si dhe për të fshehur pasurinë në pronësi, përdorim dhe posedim.

**10.4** Komisioni pa të drejtë ka konstatuar “vlerën e kufizuar provuese” të deklaratës noteriale të bërë nga z. G.S., administratori i shoqërisë {\*\*\*}SHPK, me arsyetimin se ajo është bërë nga njëra prej palëve në kontratë. Gjithashtu, sipas tij, fakti se deklarata është dhënë nga një person që ka marrëdhënie shoqërore me subjektin, nuk duhet të trajtohet si shkak papajtueshmërie për të dëshmuar apo si ndalesë për hyrje në marrëdhënie kontraktore mes të njohurish. Pra, nga njëra anë relatorja dhe shumica e ngarkojnë subjektin me detyrimin e provës për një marrëdhënie dypalëshe, nga ana tjetër nuk pranojnë deklaratimet e palës, duke e konsideruar si të pabesueshme.

**10.5** Objekti i deklaratimeve të tij përpara fillimit të detyrës nuk ka qenë përshtetimi i kohës dhe i mënyrës së pagimit, por tregimi i vlerës së përafërt të pasurisë. Deklarimi fillestar përpara detyrës nuk ka pasur për objekt as deklaratimin e mënyrës së pagesës dhe as kohën e saktë të pagimit të çmimit, por vetëm deklaratimin e vlerës së objektit të porositur. Kjo deklaratë nuk kërkonte as detaje, as dokumente shoqëruese, madje as sa i përket periudhës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit. Ndaj subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë asnjë ndryshim në deklaratimet e shpjegimet e tij në seancë apo në korrespondencat me Komisionin. Si rrjedhojë, subjekti nuk ka marrë asnjëherë hua, që ky t’ia paguante shoqërisë, por dhe të kishte detyrimin ta deklaronte.

**10.6** Konstatimi i shumicës së trupit gjykues të Komisionit, sipas të cilit “aprovimi në parim i kreditimit nuk e ngarkon as bankën, as klientin me detyrimin për nënshkrimin e kontratës së kredisë” është në kundërshtim me provat dhe ligjin. Nuk është përmendur në asnjë rast “aprovimi në parim”, por aprovimi përfundimtar i kredisë. Shumica e trupit gjykues nuk kanë arritur të arsyetojnë shkaku e derdhjes së disbursimit të kredisë në llogarinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë. Nëse qëllimi do të kishte qenë për të fshehur pasuri me këtë veprim, nuk kishte pse të bëhej me veprime bankare lehtësisht të gjurmueshme, si dhe të deklaroheshin periodikisht.

- 11.** Lidhur me pasurinë banesë me sipërfaqe 188 m<sup>2</sup> dhe oborr 337,25 m<sup>2</sup> me vendndodhje në rrugën {\*\*\*}, nr. 2, Tiranë, subjekti pretendon se fakti që nuk e ka deklaruar pasurinë shtesë me pjesë takuese prej 3/12 dhe 35,12 m<sup>2</sup> sipërfaqe bashkëpronësie në deklaratën “vetting”, nuk përbën fshehje të kësaj pasurie, pasi neni 3 i ligjit nr. 84/2016 nuk jep përkufizimin e termit “fshehje pasurie”. Fakti që subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratimin periodik të vitit 2017, provon faktin që nuk ka dashur ta fshehtë këtë shtim pasurie. Gjithashtu subjekti

pretendon në ankim se nuk është marrë vetë me procedurat e shitjes dhe regjistrimit, ndaj, për këtë arsye, ka harruar ta deklarojë shtesën e pasurisë prej 8,7 m<sup>2</sup>, por jo për qëllime fshehjeje.

12. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë, subjekti ka paraqitur në ankim shkaqet si vijojnë:

12.1 Shumica e trupit gjykues të Komisionit ka konsideruar të panevojshme dëshminë e z. A.GJ., administratorit të shoqërisë {\*\*\*}, pa dhënë arsye pse. Ishte e rëndësishme marrja e dëshmisë nga A. Gj., për të konfirmuar vazhdimin e marrëdhënies dhe pagimin e çmimit në kohë, ndaj refuzimi i marrjes së dëshmisë dhe i deklaratës noteriale është i paligjshëm.

12.2 Siç ka deklaruar edhe z. A.GJ. në deklaratën noteriale, apartamenti i banimit në fjalë është likuiduar me këste. Në vitin 1999 kur është lidhur kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., subjekti i rivlerësimit ka parapaguar shumën 8000 euro, kurse pjesa tjetër prej 33000 eurosh është paguar nga administratori i shoqërisë, z. Gj., për t'ia likuiduar subjekti i rivlerësimit me këste. Subjekti pretendon se këto këste janë paguar në këtë mënyrë: në vitin 2000 - paguar 4000 euro, në vitin 2001 - paguar 4000 euro, në vitin 2002 - paguar 4000 euro dhe në vitin 2004 - paguar 21000 euro.

12.3 Trupi gjykues i Kolegjit, pretendon subjekti, duhet t'i referohet për vlerat e përlllogaritura raportit të auditimit të përparatur nga shoqëria {\*\*\*}e ekspertit të licencuar, z. T.Gj., duke besuar në saktësinë dhe korrektësinë e tij.

12.4 Shumica e trupit gjykues të Komisionit e ka marrë të mirëqenë faktin se të gjitha pagesat e kësteve për këtë pasuri janë bërë sipas kontratës së sipërmarrjes, në një kohë që të gjitha veprimet juridike dhe provat vërtetojnë se këstet e pagesave janë ndryshuar me marrëveshje mes palëve. Për këtë arsye, subjekti pretendon se nuk ka deklaruar asnjëherë pagesa të menjëhershme as në shpjegimet dhe argumentet e paraqitura me shkrim, as në shpjegimet gjatë seancës.

12.5 Lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, nuk mund të vihet në dyshim për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të ligjshme për të cilat ka paguar detyrimet ligjore përkatëse dhe nuk është provuar apo dyshuar paligjshmëria mbi bazën e treguesve të sigurt kundër ligjshmërisë së burimit. Kjo pasuri është vënë jashtë periudhës kur subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar dhe, si rrjedhojë, mungon çdo raport shkakësia i vënies së kësaj pasurie dhe ushtrimit të funksionit sipas nenit 179/b të Kushtetutës.

12.6 Deklarimi i pasurisë ka qenë i saktë duke iu referuar dokumenteve në kontratë dhe planimetrisë të paraqitur si në deklaratën “vetting”, ashtu edhe në deklarimin e vitit 2007, por çështja qëndron në faktin se ambientet funksionale, si: ballkonet, korridoret dhe ambientet e përbashkëta nuk janë përfshirë në sipërfaqen e banimit.

13. Vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të parimeve kushtetuese dhe të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë KEDNj), si dhe të standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë GjEDNj), për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor. Subjekti pretendon gjithashtu se fakti që ai është njohur me 7 rezultatet e gjetjeve të Komisionit dhe jo me relacionin e plotë, i cili i është komunikuar vetëm në seancë dëgjimore, sjell pasojën që procesi të bëhet i pavlefshëm dhe i parregullt nga ana ligjore.
14. Subjekti pretendon se i janë lënë 15 ditë kohë për t'u mbrojtur dhe, me kërkesë të tij, i janë shtyrë edhe 5 ditë kalendarike për të realizuar mbrojtjen. Nuk është njohur me procesverbalet dhe vendimet e ndërmjetme, çka përbën një mungesë të rëndë në proces për parashikimin e KEDNj-së (referon rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar).
15. Subjekti ngre si shkak ankimor në mënyrë të përsëritur se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka

detyrimin ligjor, sipas nenit 51 të Kodit të Procedurave Administrative, të marrë në shqyrtim provat nëpërmjet përsëritjes së këtij procesi në seancë publike, me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike dhe riparimin e shkeljeve të rënda procedurale.

16. Subjekti, pasi është njohur më datë 06.06.2018 me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit që ka hetuar dhe do të shqyrtonte çështjen e rivlerësimit të subjektit, ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e anëtares së Komisionit, znj. Xh.P.. Kjo kërkesë është rrëzuar nga një tjetër trup gjykues i Komisionit, i cili ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues të Komisionit që ka kërkuar subjektin. Shkakëtarë që e kanë çuar subjektin të kërkojë përjashtimin e anëtares së Komisionit, janë për arsye të konfliktit të interesit që pretendon subjekti se ka lindur për shkak të mospranimin në një pozicion pune në bankën Raiffeisen të anëtares së trupit gjykues të Komisionit, në një kohë që Njësia e Burimeve Njerëzore në bankën Raiffeisen është drejtuar nga bashkëshortja e subjektit. Për shkak të këtij refuzimi, subjekti pretendon se ndjenja e hakmarrjes mund të ishte aktive, ndaj do të ndikonte në paanshmërinë e anëtares së Komisionit.

### **III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi procedurën**

17. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese”, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar”.
18. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji) zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012).
19. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim trupi gjykues i Kolegjit), fillimisht konstatoi se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli legjitimohet për të ushtruar ankim në Kolegj në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës (*ratione personae*) dhe se, në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i tij është depozituar brenda afatit ligjor (*ratione temporis*). Sipas dëftesës së postës rezulton se më datë 20.09.2018, ora 11:40, vendimi nr. 41, datë 18.07.2018, i Komisionit i është dorëzuar vetë subjektit. Më datë 03.10.2018, subjekti ka paraqitur ankimin brenda 15 ditëve që është afati ligjor për të ushtruar ankim.
20. Subjekti më datë 21.01.2019, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet e tij me shkrim, pas njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, të cilave u ka bashkëlidhur një CD me provat, të cilat i rendit dhe i analizon në parashtrimet që ka dorëzuar. Sipas verifikimit të bërë në aktet e dosjes së ardhur nga Komisioni, konstatohet se përveç kërkesës për këqyrje të sipërfaqes së parcelës, sipërfaqes së oborrit dhe sipërfaqes nën ndërtesë të pasurive nr. 1 dhe nr. 4, të gjitha provat e tjera të renditura nga ankuesi ndodhen në dosje. Në lidhje me këqyrjen që pretendon të kryhet, edhe pse nuk është një kërkim eksplisit i ankuesit, trupi gjykues i Kolegjit kryesisht

vlerëson se nuk është e nevojshme të realizohet në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi faktet që kërkohen të vërtetohen drejtpërdrejt nga gjykata nëpërmjet këqyrjes janë të panevojshme dhe pasi këto fakte nuk kanë ndikuar në vendimmarrjen e Komisionit.

21. Në Kolegj janë paraqitur denoncime në datat 02.05.2018, 08.06.2018 dhe 28.01.2019 për subjektin e rivlerësimit, respektivisht nga shtetasit V. Ç., D. E. dhe R. M.. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi vlerësoi këto denoncime sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi për mosfillimin e hetimit për praktikën e denoncimeve të këtyre shtetasve, pasi shkeljet e pretenduara nuk përmbanin shkaqe të mjaftueshme për t’u hetuar.
22. Nëpërmjet ankimit, është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli shqyrtimi i çështjes në seancë publike gjyqësore. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se debati gjyqësor në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, është i panevojshëm pasi: a) vlerësohet se konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë e të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike e konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk vlerësohet se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision, si rrjedhojë nuk jemi para kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.
23. Subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i është nënshtruar procesit administrativ të rivlerësimit *ex officio*. Meqenëse subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi.
24. Më datë 12.12.2017, me vendimin nr. 1, Komisioni ka vendosur të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016.
25. Rezulton se më datë 18.06.2018, Komisioni bazuar në nenin 45 e vijues të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Artan Zeneli, për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, duke arritur në përfundimin se provat e administruara dhe gjetjet e Komisionit kishin arritur nivelin e provueshmërisë për këto dy kriteret. Rezultatet e hetimit i janë njoftuar subjektit më datë 19.06.2018, duke i kaluar barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe njëkohësisht duke i dhënë të drejtën për t’u njohur me provat e administruara sipas nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të drejtën për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit.
26. Më datë 09.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar me anë të postës elektronike shpjegimet dhe provat e tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe gjetjeve të Komisionit.
27. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, duke dërguar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, raportin për kontrollin e figurës. Në këtë raport, DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli. Rezulton gjithashtu se Komisioni i është drejtuar DSIK-së për të rishikuar raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Grupi i punës, në



rivlerësimin e të dhënave të marra pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit Artan Zeneli, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.03.2018, ka paraqitur raportin e rishikuar për të. Në raportin e rishikuar evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës, çka e ngarkon atë me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe të plotësimit jo me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës, duke e bërë të papërshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

28. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) nëpërmjet raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar, ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, nga i cili ka rezultuar se për subjektin Artan Zeneli:
- o Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
  - o Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
  - o Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
  - o Nuk ka kryer deklaram të rremë.
  - o Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
29. Komisioni me vendimin nr. 41, datë 18.07.2018, bazuar në provat e administruara, gjetjet, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, ka arritur në përfundimin që subjektin Artan Zeneli, gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
30. Nëpërmjet ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli kërkon: Ndryshimin e vendimit nr. 41, datë 18.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas nenit 66, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, ose prishjen e vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe, në bazë të nenit 58, germa "a" dhe nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, duke parashtruar në ankim shkaqet mbi të cilat mbështeten pretendimet e tij.

### **Lidhur me pretendimin dhe shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit për shkelje të procesit të rregullt ligjor në Komision**

31. Subjekti pretendon se vendimi në Komision është marrë në shkelje të parimeve kushtetuese dhe të KEDNj-së dhe standardeve të GjEDNj-së për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor. Gjithashtu fakti që subjekti është njohur me 7 rezultatet e gjetjeve të Komisionit dhe jo me relacionin e plotë, i cili i është komunikuar vetëm në seancë dëgjimore, ka bërë që procesi të bëhet i pavlefshëm dhe i parregullt ligjor. Subjekti pretendon se i janë lënë 15 ditë kohë për t'u mbrojtur dhe, me kërkesë të tij, i janë shtyrë edhe 5 ditë kalendarike për të realizuar mbrojtjen. Nuk është njohur me procesverbalet dhe vendimet e ndërmjetme, çka përbën një mungesë të rëndë në proces për parashikimin e nenit 6, paragrafi i parë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim KEDNj). Për këtë shkelje të pretenduar, subjekti i rivlerësimit referon nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GjEDNj) rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar.

31.1 Në analizë të shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, më datë 18.06.2018, trupi gjykues nr. 4 i Komisionit, me vendimin nr. 2, ka vendosur të përfundojë

hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Artan Zeneli, për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, duke arritur në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këto dy kriteret, bazuar në nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Këto rezultate iu njoftuan edhe subjektit më datë 19.06.2018, duke i njoftuar njëkohësisht edhe kalimin e barrës së provës, të drejtën e njohjes me provat e administruara sipas nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të drejtën e tij që të provonte të kundërtën në rast se do të kishte prova, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*.

**31.2** Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë 23.06.2018, ka kërkuar nga Komisioni që t'i vihet në dispozicion metodika e përlllogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni, si dhe një zgjatje afati për të paraqitur mbrojtjen. Komisioni i ka vënë në dispozicion subjektit metodikën financiare, si dhe afatin shtesë prej 5 ditësh të paraqitjes së shpjegimeve të tij. Pas njohjes me dosjen, subjekti ka paraqitur shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, më datë 09.07.2018, duke bashkëlidhur provat në mbështetje të tyre. Në seancën dëgjimore në Komision, më datë 16.07.2018, relatorja e çështjes në Komision ka prezantuar rezultatet e hetimit, të njëjta me ato që i ishin bërë të njohura subjektit me anë të vendimit nr. 2, datë 18.06.2018, të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet dhe provat mbi konstatimet dhe rezultatet e Komisionit.

**31.3** Lidhur me vendimet e ndërmjetme të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni, pasi i është komunikuar vendimmarrja e arsyetuar në seancë dëgjimore për mospranimin e kërkesës së tij për përfshirjen edhe të kriterit të tretë, atij profesional, në procesin e rivlerësimit. Sa u përket procesverbaleve të mbajtura në dhomë këshillimi, ato janë akte të brendshme dhe të hartuara në Komision, të cilat reflektojnë vendimmarrjen për të cilën subjekti është vënë në dijeni. Gjithsesi, mosnjohja e subjektit me to nuk është shkak për proces të parregullt ligjor. Sa i përket rastit Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, që subjekti referon për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit vëren se jurisprudenca e krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për atë çështje nuk gjen zbatim në rastin konkret. Në atë çështje, GjEDNj ka vlerësuar për rastin në fjalë se nuk dilnin në pah probleme të veçanta sipas neneve 6 dhe 8 të KEDNj-së. Pra, rasti që është cituar nga subjekti për analogji të shkeljes, nuk ka lidhje me mangësitë e pretenduara. Në këtë çështje, GjEDNj ka vlerësuar se detyrimi për një hetim efektiv siguron zbatimin efektiv të legjislacionit të brendshëm.

**31.4** Nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision, nga trupi gjykues i Kolegjit konstatohet se subjektit të rivlerësimit i është respektuar e drejta për një proces të rregullt dhe ligjor. Konkretisht, vërtetohet se subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, në Komision i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një organ i pavarur dhe i paanshëm. Sipas akteve të administruara në proces, Komisioni i ka dhënë më parë të drejtën për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, të depozitohet prova, si dhe vendimi i është komunikuar publikisht. Komisioni me të drejtë i ka marrë në konsideratë provat dhe i ka vlerësuar sipas bindjes së tij për vlerën e tyre provuese. *Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkeljet kushtetuese, nuk është i bazuar.*

- 32.** Subjekti i rivlerësimit ngre si shkak ankimor në mënyrë të përsëritur se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka detyrimin ligjor, sipas nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, të marrë në shqyrtim provat

nëpërmjet përsëritjes së këtij procesi në seancë publike, me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike dhe riparimin e shkeljeve të rënda procedurale.

**32.1** Nga trupi gjykues i Kolegjit, është vlerësuar se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e palëve është i panevojshëm, siç është arsyetuar në paragrafin nr. 22 të këtij vendimi.

*Referuar analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit ka vlerësuar që shqyrtimi i vendimit të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, të zhvillohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh.*

### **Lidhur me shkaqet e ankimit kundër vendimit të Komisionit mbi rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues të Komisionit**

- 33.** Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur më datë 06.06.2018 me përbërjen e trupit gjykues që ka hetuar dhe do të shqyrtonte çështjen e rivlerësimit të subjektit, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, znj. Xh.P.. Kjo kërkesë është rrëzuar nga një tjetër trup gjykues, i cili ka vendosur mospranimin e përjashtimit të anëtares së trupit gjykues që ka kërkuar subjekti i rivlerësimit. Përveç vendimit përfundimtar, subjekti i rivlerësimit ankohet edhe për këtë vendim, duke pretenduar se shkaqet që e kanë çuar të kërkojë përjashtimin e anëtares së trupit gjykues të Komisionit janë arsytet e konfliktit të interesit që pretendon subjekti se ka lindur për shkak të mospranimit në një pozicion pune në bankën Raiffeisen të anëtares së trupit gjykues, në një kohë që Njësia e Burimeve Njerëzore është drejtuar nga bashkëshortja e tij. Për shkak të këtij refuzimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se ndjenja e hakmarrjes mund të jetë aktive, ndaj do të ndikonte në paanshmërinë e anëtares së trupit gjykues.

**33.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367), përkufizon termin “konflikt interesi” si vijon: “*Konflikt i interesit*” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisve të tij publike. Në rastin konkret, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, detyra publike e anëtares së trupit gjykues është identifikuar, por nuk është identifikuar ndonjë interes privat i cili mund të ndikojë në kryerjen e padrejtë të detyrës së saj.

**33.2** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se anëtarja e trupit gjykues të Komisionit ka aplikuar për një vend pune më datë 26.06.2010 në Raiffeisen Bank, gjatë kohës kur bashkëshortja e subjektit ishte punonjëse e bankës, dhe mospranimi në punë është më se normal në një garë ku konkurrojnë shumë kandidatë. Kolegji çmon se në raste të tilla nuk dihet dhe as njihet personi i cili ka bërë përzgjedhjen për të mos u kualifikuar një pjesë e kandidatëve. Nuk përbën shkak për armiqësi dhe nuk është prezent një konflikt apo urrejtje, siç pretendon subjekti, vetëm për arsye se nuk është pranuar në punë. Procesi i rekrutimit, si rregull, nënkupton aplikimin e shumë kandidatëve dhe përzgjedhja bëhet nga një grup njerëzish për të siguruar cilësi të vendimmarrjes. Komisionerja, e pyetur nga trupi gjykues i shortuar për të marrë vendim, u shpreh se ajo nuk ishte në dijeni të personit që mori vendimin përfundimtar. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se situata e parashtruar nga subjekti nuk përbën rast për armiqësi apo konflikt interesi të pretenduar. Gjithashtu, nuk identifikohen interesa privatë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në mënyrë që të kenë ndikuar në kryerjen e detyrës së anëtares së Komisionit.

**33.3** Për të vijuar me analizën, subjekti i rivlerësimit referon si të ngjashëm, nga jurisprudenca e GjEDNj-së, rastin Pescador Valiero kundër Spanjës (2003), i cili lidhet saktësisht me një konflikt interesi, ku një gjyqtar gjykon një çështje për largim nga puna në një universitet, tek i cili kishte dhënë lëndë drejtësie, pra ishte paguar nga ky universitet. Marrëdhënia financiare që

gjyqtari ka pasur me universitetin, përbën gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë me universitetin, duke ndikuar në kryerjen e padrejtë të detyrës. Për t'u kthyer në rastin konkret të anëtares së trupit gjykues të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nuk kemi prezent gjendje konflikti interesi, si në rastin e sipërcituar të GjEDNJ-së, pasi nuk ka pasur interesa privatë në kuptim të nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005. Situata do të ishte e ngjashme nëse anëtarja e trupit gjykues është larguar nga puna në bankën ku punon bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe nga kjo marrëdhënie e largimit të jetë krijuar armiqësi dhe urrejtje për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies financiare, ndërprerje e cila mund të afektojë jetën në vazhdim, si dhe karrierën e punonjësit të larguar. Në këtë rast, nuk identifikohet përfshirje e anëtares së trupit gjykues në interesa privatë, siç pretendohet nga subjekti i rivlerësimit.

**33.4** Vetë anëtarja e trupit gjykues, kur është pyetur nga trupi tjetër gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtim në seancën dëgjimore të datës 11.06.2018, ka deklaruar se ajo e ka bërë atë aplikim 8 vite më parë dhe se nuk kishte asnjë njohje me bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk kishte asnjë informacion për refuzimin e aplikimit të kryer. Ajo shpjegon edhe faktin se meqë ka punuar në sistemin bankar, ishte e vetëdijshme se përzgjedhja e konkurruesve nuk bëhej nga një individ i vetëm, por nga të gjithë drejtuesit e bankës, të cilët bënin përzgjedhjen e kandidaturës së përshtatshme. Si rrjedhojë, anëtarja e trupit gjykues sqaron se nuk ka asnjë konflikt interesi dhe as njohje me bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit.

*Në përfundim të vlerësimit, Kolegji arrin në konkluzionin se nuk ka gjendje të konfliktit të interesit të anëtares së trupit gjykues në Komision, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.*

*Sa u përket shkaqeve të mësipërme, pretendimet e subjektit nuk janë të bazuara.*

#### **IV. Analiza e trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet ligjore të ankimit**

- 34.** Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit ka ngritur pretendimin se vlerësimi i pasurisë nuk ka kufizim në kohë, ndryshe nga vlerësimi i figurës dhe ai profesional, por gjithsesi është i lidhur ngushtë me funksionin e gjyqtarit. Shumica e pasurive mbi të cilat ka gjetur parregullsitë Komisioni, janë krijuar në pjesën më të madhe gjatë ushtrimit të profesionit të ligjshëm si avokat dhe jo gjatë ushtrimit të profesionit si gjyqtar.

**34.1** Në lidhje me shkakun e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se verifikimi dhe kontrolli i ligjshmërisë së pasurive të subjekteve të rivlerësimit dhe i burimit të krijimit të tyre shtrihet në kohë, edhe përpara qenies së subjekteve të rivlerësimit në detyrën e gjyqtarit apo prokurorit.

**34.2** Sipas dispozitave ligjore e nënligjore të renditura më poshtë –

- o nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet: *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*
- o pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës ku parashikohet: *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave [...].*
- o nenit 50, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 ku parashikohet: *“Institucionet e rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit [...].*
- o nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 ku parashikohet: *Objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së*

*detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.*

– trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se nevoja për verifikimin dhe kontrollin e pasurisë dhe të burimit të krijimit të saj shtrihet në kohë edhe përpara qenies në detyrën e gjyqtarit, prokurorit etj. Për më tepër, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, te rubrika “Deklarimi i pasurive” parashikohet se duhet të deklarohen: *Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.* Në deklaratën e pasurive të subjekteve nuk parashikohet të përjashtohen nga deklarimi pasuritë e akumuluar jashtë funksionit të gjyqtarit apo prokurorit.

Në udhëzimin nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2016, të ILKPKI-së “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, deklarimi i pasurisë përcaktohet të bëhet: *Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre*”. Për sa më sipër, arsyetohet se pretendimi i ankuesit është i pambështetur në ligj dhe akte nënligjore. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se, për vlerësimin e pasurisë, ligji nuk kufizon as kohën dhe as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre.

*Sa më sipër, shkak i ngritur nga subjekti nuk është i bazuar në ligj.*

35. Subjekti pretendon se hetimi i Komisionit nuk ka qenë i thellë dhe i gjithanshëm, pasi subjektit nuk i janë përfshirë dhe as njoftuar rezultatet lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Sipas subjektit, Komisioni ka paragjykuar çështjen duke mos dhënë argumente përse nuk e ka pranuar kërkesën për t’u njohur me rezultatet e hetimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, me arsyetimin e vetëm se subjekti i rivlerësimit nuk arriti me provat dhe shpjegimet e paraqitura të provojë të kundërtën.

35.1 Në analizë dhe shqyrtim të shkakut të mësipërm, rezulton se në seancën dëgjimore të datës 16.07.2018, në Komision subjekti ka paraqitur kërkesë për përfshirjen edhe të kriterit të tretë, atij të vlerësimit profesional në procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues i Komisionit, në dhomë këshillimi ka vendosur me shumicë votash të mos pranojë kërkesën e subjektit, pasi për kriteret e figurës dhe të pasurisë, provat kishin nivelin e provueshmërisë dhe subjekti me shpjegimet dhe provat e paraqitura nuk arriti të provojë të kundërtën.

35.2 Ndryshe nga sa pretendon subjekti, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, arsyetohet se si rivlerësimi, ashtu edhe vendimi, si edhe në rastin konkret, mund të bazohet edhe në një ose dy kritere të rivlerësimit. Me të drejtë, Komisioni në këtë rast, bazuar edhe në nivelin e provueshmërisë së provave sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës dhe, mbi provat e paraqitura nga subjekti, ka vendosur bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, siç ka disponuar. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se Komisioni ka vendosur drejt duke rrëzuar kërkesën e subjektit për përfshirjen edhe të kriterit të tretë, atij të vlerësimit profesional në procesin e rivlerësimit.

*Sa më sipër, ky shkak i ngritur nga subjekti nuk është i bazuar në ligj.*

36. Subjekti pretendon se lidhur me hetimin, nuk janë shqyrtuar argumentet dhe kundërshtimet e subjektit për pagesat e pasurive me këste.

36.1 Në analizën e shkakut të mësipërm, ndryshe nga sa pretendon ankuesi, rezulton se pasuritë të cilat pretendohet se janë paguar me këste, janë pasuritë e numërtuara sipas këtij vendimi me nr. 3 dhe nr. 4, të cilat janë trajtuar nga Komisioni dhe për të cilat subjektit i është kaluar barra e provës pikërisht për të dëgjuar dhe vlerësuar argumentet, kundërshtimet, si dhe provat lidhur me këto pagesa. Sa i përket vlerës provuese të provave, si dhe bindjes së brendshme, Komisioni me të drejtë është shprehur në mënyrë të veçantë për secilën nga pasuritë objekt vlerësimi.

*Shkaku i mësipërm, i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar.*

37. Subjekti pretendon se vlerësimi i trupit gjykues në Komision është i pasaktë dhe i pavërtetë. Procesi i rivlerësimit nuk ka qenë i paanshëm, pasi është kryer një hetim sekret dhe jo i mirëfilltë. Provat që janë mbledhur kryesisht, në mënyrë të njëanshme, e që janë të papërsëritshme nuk i janë njoftuar subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka të drejtën të njihet me të gjitha provat e grumbulluara, pavarësisht nga përfshirja e tyre në proces.

37.1 Sipas analizës së shkakut ankimor të mësipërm, nga trupi gjykues i Kolegjit konstatohet se, pasi u verifikuan aktet në dosjen e ardhur nga Komisioni, ndryshe nga sa pretendon ankuesi, rezulton se më datë 19.06.2018, është njoftuar subjekti për rezultatet e hetimit, kalimin e barrës së provës, të drejtën për njohjen e provave të administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të drejtën për të paraqitur prova për të provuar të kundërtën e gjetjeve të arritura nga hetimi paraprak i kryer nga Komisioni, brenda 15 ditëve nga njoftimi me postë elektronike.

37.2 Gjithashtu, rezulton se subjektit me kërkesën e tij, i është vënë në dispozicion metodologjia e llogaritjeve financiare, duke i shtuar afatin e paraqitjes së shpjegimeve, përsëri me kërkesën e tij. Në seancën dëgjimore të datës 16.07.2018, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur pretendime për ndonjë provë të panjohur nga ana e tij apo që nuk i është vënë në dispozicion nga Komisioni.

Si rrjedhojë, nuk konstatohet që subjektit t'i jenë shkelur të drejtat e një procesi të rregullt ligjor, që kanë të bëjnë me të drejtën e mbrojtjes dhe përfaqësimit, të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të dhënë mendime dhe shpjegime, si dhe për të paraqitur prova.

*Në analizë të sa më sipër, ky shkak i ngritur nga subjekti nuk është i bazuar.*

38. Një tjetër shkak ankimor i subjektit, është se Komisioni mbi të njëjtat prova të paraqitura nga ana e subjektit për pasuritë, pa dhënë asnjë arsye, ka arritur në konkluzion të kundërt me hetimin e kryer nga ILDKPKI-ja. Subjekti pretendon se, nga ana tjetër, lidhur me raportin fillestar të DSIK-së, relatorja dhe shumica e trupit gjykues në vend që të arsyetonin dhe të kryenin hetimin e tyre të gjithanshëm, i kanë kërkuar DSIK-së të rishikojë raportin. Subjekti pretendon se me këto veprime është shkelur neni 253 i Kodit të Procedurës Civile për provueshmërinë e plotë të shkresave zyrtare.

38.1 Në analizë të shkakut të mësipërm, ndryshe nga sa pretendon ankuesi, vërehet dhe konkludohet se bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016, i cili të referon te neni 33 i këtij ligji, ku parashikohet se ILDPKI-ja kryen një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin nr. 84/2016, ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (në vijim ligji nr. 9049), si dhe në ligjin nr. 9367/2005, parashikimi ligjor i verifikimit të pasurive, burimeve të krijimit të tyre, dokumentacionit justifikues ose informacioneve për pasuritë në pronësi apo përdorim të subjekteve të rivlerësimit, nuk kufizohet vetëm në deklaratimet e pasurisë sipas deklaratës "vetting", por edhe në deklaratimet periodike të pasurisë. Këto dokumente ose informacione

mund të përdoren dhe vlerësohen në cilësinë e provave, por referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji, në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, realizojnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse. Mbi sa më sipër, çmohet se në përputhje me nenin Ç, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka vlerësuar drejt raportet e institucioneve shtetërore mbështetëse të ILDPKI-së dhe DSIK-së, pasi i ka analizuar. Kërkimi i një raporti të ri nga DSIK nuk përbën shkelje të nenit 253 të KPC, pasi rishikimi i raportit të DSIK-së ka ardhur për shkak se Komisioni ka gjetur fakte të reja, mbi të cilat duhet të arrinte në përfundime nëpërmjet një raporti tjetër.

*Sa më sipër, ky shkak ankimor i ngritur nga subjekti, nuk është i bazuar në ligj.*

39. Subjekti pretendon në ankim se gjetja që i ka rezultuar Komisionit, në lidhje me revokimin e vizës nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë, nuk është e sqaruar se në ç'mënyrë ka afektuar kriterin e kontrollit të figurës, pa përmendur rrethanat nga ana e Komisionit, me qëllim që të pengojë mbrojtjen efektive nga ana e subjektit. Subjekti ankohet se i është njoftuar një konkluzion i përgjithshëm dhe i padetajuar, duke bërë një shtrembërim të fakteve të cilat nuk qenë parashtruar në rezultatet e hetimit lidhur me kontrollin e figurës. Subjekti pretendon gjithashtu në ankim se mungon raporti i shkakësisë midis kësaj gjetjeje dhe objektit të kontrollit të figurës, në një kohë që DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve, subjekti pretendon se i është mohuar e drejta e një mbrojtjeje efektive, pasi nuk i janë paraqitur në kohë detajet e nevojshme për gjetjen e konstatuar.

39.1 Duke analizuar shkakun e mësipërm, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se më datë 19.06.2018, subjekti është njoftuar rregullisht nga Komisioni mbi rezultatet e hetimit, barrën e provës dhe të drejtën e njohjes me provat. Në rezultatin nr. 7 të hetimit, siç e ka numërtuar Komisioni, i është njoftuar subjektit: *Nga hetimi rezulton se ju është revokuar viza e ShBA më datë 26.01.2017. Dorëzimi fizik i deklaratës së kontrollit të figurës nga ju është bërë në datën 27.01.2017. Rezulton se nuk keni deklaruar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi revokimin e vizës suaj nga Ambasada e ShBA-së, në momentin kur keni dorëzuar "Deklaratën për kontrollin e figurës", sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016.* Nga ky njoftim i rezultatit, subjektit i është bërë me dije se ka një gjetje me rrethana të ndryshme nga ato çfarë ka deklaruar në formularin e kontrollit të figurës, për të cilën i është kërkuar të japë shpjegime, si dhe të provojë të kundërtën, duke i njoftuar gjithashtu edhe provat ku e bazojnë rezultatin e hetimit. Lidhur me këtë rezultat, subjekti ka paraqitur edhe shpjegimet e tij, duke prapësuar arsyet përse nuk e ka deklaruar revokimin e vizës amerikane. Përveç shpjegimeve, subjekti ka paraqitur edhe provat shkresore mbi të cilat bazon pretendimet e tij.

39.2 Në vazhdim të analizës së shkakut më sipër, nga trupi gjykues i Kolegjit arsyetohet se, përderisa Komisioni do të zhvillonte seancë dëgjimore dhe subjekti në kuadër të parimit të kontradiktoritetit kishte të drejtë të paraqiste prova, materiale, shpjegime dhe parashtrime, vendimi si me sipër i Komisionit, sipas vlerësimit të trupit gjykues të Kolegjit, nuk përbën paragjykim të subjektit pasi Komisioni, me kalimin e barrës së provës subjektit, mund të ndodhte që me provat e sjella nga ai, si gjatë hetimit, ashtu dhe në seancë dëgjimore, të bindej për të kundërtën e rezultateve të hetimit. Ndaj, siç rezulton nga materialet në dosje, subjektit i janë garantuar të gjitha të drejtat për realizimin e një mbrojtjeje efektive.

*Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit lidhur me këtë shkak ankimor, nuk është i bazuar në prova e në ligj.*

40. Subjekti ngre si shkak ankimor se faktet në lidhje me gjetjen për revokimin e vizës i janë njoftuar për herë të parë pas zbardhjes së vendimit, duke shtrembëruar kështu faktet dhe duke

i shtuar për herë të parë në vendimin përfundimtar, duke anashkaluar parimet themeltare të një procesi të drejtë administrativ, civil, penal apo kushtetues.

**40.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, duke iu referuar materialeve që gjenden në dosje, rezulton se subjekti është njoftuar për rezultatet e hetimit, siç është detajuar në paragrafin 39.1, duke i dhënë edhe mundësinë të japë shpjegimet e veta, madje duke i zgjatur kohën e dorëzimit të shpjegimeve me kërkesën e tij, duke i garantuar kështu të drejtën për t'u njohur me materialet në dosje, metodikën e përlllogaritjeve financiare, si dhe me rezultatet e hetimit. Nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision, nga trupi gjykues në Kolegj konstatohet se subjekti të rivlerësimit i janë respektuar të drejtat për një proces të rregullt dhe ligjor. Konkretisht, rezulton se subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, në Komision i është garantuar e drejta që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një organ administrativ kushtetues i pavarur dhe i paanshëm, vendimi i të cilit i është komunikuar publikisht, duke i dhënë më parë të drejtën për të paraqitur mendime dhe shpjegime për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, si dhe të depozitojë prova në mbështetje të pretendimeve të tij. *Pretendimi i subjektit lidhur me këtë shkak ankimor nuk është i bazuar as në ligj, as në prova.*

### **Shkaqet ankimore në lidhje me vlerësimin e kriterit të figurës dhe analizimi i tyre**

- 41.** Subjekti pretendon se shumica e trupit gjykues të Komisionit nuk ka bërë një analizë ligjore për të përcaktuar nëse koncepti i refuzimit të hyrjes është i njëjtë me konceptin e revokimit të vizës. Revokimi i vizës dhe refuzimi i hyrjes janë koncepte krejtësisht të ndryshme, të cilat nuk përbëjnë të njëjtën gjë. Refuzimi i hyrjes është një instrument në politikën e emigracionit të ShBA-së dhe është një masë administrative ose gjyqësore, e cila u jepet të huajve të cilët janë subjekt deportimi në ShBA. Ndërsa revokimi i vizës është një institut tjetër ndaj personave që shpallen *non-grata* dhe u përcaktohet shkak dhe afati i ndalimit. Në rastin konkret, pretendon subjekti, konsullata i konfirmon poseduesit të vizës se ka të drejtë të aplikojë për një vizë tjetër, çka nënkupton se ndaj tij nuk ka një ndalim hyrjeje.

**41.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni drejtësisht ka bërë një vlerësim të saktësisë së deklarimeve të subjektit dhe vërtetësisë së tyre, duke u mbështetur edhe në raportin e rishikuar të DSIK-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.03.2018, i cili evidenton faktin se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e “Deklaratës së kontrollit të figurës” në shtojcën 3 të ligjit nr. 84/2016, pjesa 5 “Të dhëna për sigurinë”, germa “g”. Mosdeklarimi i faktit, në këtë rast e ngarkon subjektin e rivlerësimit me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe plotësimin jo me vërtetësi të “Deklaratës për kontrollin e figurës”.

**41.2** Në vazhdim të analizës së shkakut të mësipërm, subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij trajton diferencën ndërmjet refuzimit të hyrjes dhe revokimit të vizës, duke pretenduar që një trajtim të tillë duhet të kishte bërë edhe Komisioni, me arsyetimin se revokimi i vizës nuk është në vetvete një refuzim nga ana e Ambasadës së ShBA-së në Tiranë. Gjithsesi, po të bëjmë diferencën ndërmjet revokimit të vizës dhe refuzimit të hyrjes, e para ka të bëjë me anulimin e një vize ekzistuese, siç e kemi konkretisht në rastin e subjektit të rivlerësimit. Sa i përket refuzimit të hyrjes, realizohet në dy mënyra, nëpërmjet refuzimit të dhënies së vizës në ambasadë, si dhe refuzimit të lejimit të hyrjes në kufi të një shteti të caktuar. Duke qenë se viza është mjete i cili lejon hyrjen në një shtet të caktuar, në hyrjen e të cilit kërkohet pajisja me vizë, të dyja këto raste (revokimi dhe refuzimi), edhe pse kanë procedura të ndryshme administrative, në thelb kanë si qëllim moslejimin e personit të hyjë në shtetin e caktuar dhe, nëse ka hyrë, të ndërpresë qëndrimin. Më poshtë më shumë detaje.



**41.3** Përveç faktit të refuzimit të vizës turistike B/2<sup>1</sup>, subjekti i rivlerësimit ishte mbajtës i një tjetër vize amerikane, e tipit A, e lëshuar nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë për qëllime zyrtare. Nisur nga ky fakt, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Ambasadës së ShBA-së më datë 04.06.2018, ora 12:49, nëpërmjet *e-mail*-it, për t'i konfirmuar nëse kjo vizë është akoma e vlefshme. Më datë 14.06.2018, ora 02:06 pm, kjo ambasadë, i kthen përgjigje me *e-mail* subjektit të rivlerësimit se viza zyrtare e tipit A i është revokuar më datë 05.06.2018, dhe duhej të paraqitej që të bëhej edhe kancelimi fizik i kësaj vize. Ky veprim i menjëhershëm i ndërmarrë nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë, tregon se zyra konsullore e saj duket se ka pasur jashtë vëmendjes faktin që subjekti i rivlerësimit ka qenë i pajisur me dy viza të tipave të ndryshëm për të hyrë në ShBA. Rrjedha imediate e veprimeve të ambasadës në fjalë dëshmon vullnet për të mos i lënë subjektit të rivlerësimit asnjë mjet tjetër për të hyrë në ShBA.

**41.4** Trupi gjykues vëren gjithashtu se legjislacioni federal i ShBA-së<sup>2</sup>, konkretisht INA në 8 USC 2101(i), duket se shoqëron revokimin e vizave nga oficerët konsullorë të ShBA-së me protokollin e lajmërimit të menjëhershëm të kësaj mase zyrtare të Doganës dhe Kontrollit Kufitar të çdo porte hyrëse në ShBA. Më konkretisht, sipas rregullores së Departamentit të Shtetit, 22 CFR: “[...] (c) Përveç rasteve kur udhëzohet ndryshe nga Departamenti, oficeri konsullor nëse është praktikisht e mundshme, do të lajmërojë të huajin për të cilin është lëshuar viza, se viza i është revokuar ose revokuar përkohësisht. Pavarësisht nga ky lajmërim, sapo të evidentohet revokimi në Sistemin e Sinjalizimit dhe Mbështetjes Konsullore të Departamentit (SSMKD), viza nuk konsiderohet më e vlefshme për udhëtim në ShBA. [...]”<sup>3</sup>

**41.5** Lidhur me sistemin *online* SSMKD, një studim i rregullave federale të Aktit të Natyralizimit dhe Imigrantëve nxjerr në pah se informacioni i përmbajtur në SSMKD, që përfshin ndër të tjera edhe revokimin e vizave të joemigrantëve, ndahet menjëherë, përveç të tjerave, edhe me *Customs and Border Protection*<sup>4</sup> (*Doganat dhe Mbrojtja e Kufijve*, Agjenci Federale e ShBA-së) për të identifikuar individët hyrja e të cilëve në ShBA është revokuar përkohësisht ose për një afat më të gjatë.

**41.6** Në arsyetim të dispozitave të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se dallimi që pretendon subjekti i rivlerësimit mes konceptit të revokimit të vizës dhe të refuzimit të hyrjes është artificial, pasi revokimi i vizës është hallka e parë e një procesi<sup>5</sup> që përmbillet me thirrjen dhe informimin e detajuar të shkaqeve të bazuara në fakte dhe në ligj që sjellin për pasojë këtë hap zyrtar. Rezulton që lajmërimi i revokimit të një vize evidentohet menjëherë në sistemin informativ të autoriteteve federale<sup>6</sup> që përfshihen në proces dhe pasojë e të cilit, në raste përjashtimore, është refuzimi i hyrjes – përjashtimisht, kur individ i nuk mund të thirret fizikisht në Konsullatë dhe paraqitet në një port hyrës në ShBA<sup>7</sup>. Në rastin konkret, duke ndjekur ligjet

---

<sup>1</sup> Për llojet e vizave, shih: <https://travel.state.gov/content/travel/en/us-visas/visa-information-resources/all-visa-categories.html>

<sup>2</sup><https://www.govinfo.gov/content/pkg/CFR-2018-title22-vol1/xml/CFR-2018-title22-vol1-sec41-122.xml>

<sup>3</sup>DOS regulations at 22 CFR 41.122(c) p dhe FAM 403.11-4(A)(3)

<sup>4</sup>Shih <https://www.state.gov/documents/organization/242321.pdf>

<sup>5</sup>Procesi në fjalë, për shkak të vizës zyrtare të subjektit (Visa class A) ka përshkuar edhe hapa të tjerë të ndërmjetëm, të ndjekur nga Shërbimi Konsullor: (CT:VISA-1; 11-18-2015) “[...]b. (U) Siç kërkon 22 CFR 41.122(e), Departamenti [...] Divizioni i Marrëdhënieve Diplommatike (CA/VO/DO/DL), Shefi i Protokollit (S/CPR), dhe seksioni përkatës i vendit, si dhe Departamenti i Sigurisë së Brendshme (DHS), në Washington, DC duhet të njoftohen menjëherë kur revokohet zyrtarisht një vizë diplomatike ose zyrtare apo një vizë e klasifikuar në kategorinë A, G, C-2, C-3, ose NATO.[...]”

<sup>6</sup> Sistemin e Sinjalizimit dhe Mbështetjes Konsullore të Departamentit (SSMKD).

<sup>7</sup> “[...] c. (U) Siç kërkon 22 CFR 41.122(d) dhe 22 CFR 41.122(e), kurdoherë që një vizë revokohet, por oficeri konsullor nuk mund të anulohet vizën fizikisht, ky i fundit duhet të njoftojë Zyrën e Kontrollit, Analizës dhe

dhe aktet nënligjore federale të ShBA-së trupi gjykues i Kolegjit vëren që revokimi fizik i vizës në pasaportë, në prani dhe pasi i shpjegohet vetë individit të cilit i revokohet viza, është hapi përmbyllës gjatë të cilit shpjegohet masa, arsyet dhe pasoja e kohëzgjatja e saj, nëse është rasti.

**41.7** Trupi gjykues i Kolegjit prezumon që subjekti i rivlerësimit në momentin e revokimit të vizës duhet të jetë informuar në mënyrë shteruese me shkrim dhe me gojë për sa më sipër dhe duhet të ketë qenë i qartë për fatin e vizës së tij dhe arsyet e revokimit të saj. Si rrjedhojë, justifikimi i parashtruar prej subjektit që revokimi i vizës turistike nuk barazohej me refuzim hyrjeje, pasi ai vazhdonte të gëzonte vizë zyrtare, nuk mund të pranohet pasi sfidon logjikën. Gjatë revokimit të vizës, subjektit duhet t'i jetë bërë i qartë qëndrimi i përfaqësuesve të Departamentit të Shtetit lidhur me mundësinë e tij për të hyrë në ShBA si individ, çka duhet të kishte shërbyer objektivisht si sinjal i një detaji që duhet të ishte pasqyruar në deklarin sipas Shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Viza zyrtare, nga ana tjetër, është një privilegj që u jep përparësi marrëdhëniesve miqësore diplomatike mes vendeve dhe respektimit të institucioneve zyrtare dhe që mund të anashkalojë edhe problemet që autoritetet federale mund të kenë me vetë individin<sup>8</sup>. Për këtë arsye, fakti që aty për aty revokimi nuk përfshiu edhe vizën zyrtare, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit është i papërfillshëm dhe i papranueshëm si arsyetim që çliron nga përgjegjësia për deklarin subjektin.

*Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se qëllimi i revokimit të vizës së tipit B/2 për subjektin e rivlerësimit Artan Zeneli, ishte refuzimi i hyrjes së tij në territorin e ShBA-së.*

- 42.** Subjekti pretendon se, duke iu referuar pyetjes së pjesës 5, germa “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, e cila përmban tekstin: *Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?* – periudha e deklarinimit janë 10 vitet e fundit, ndërsa afati për deklarinimin e këtyre fakteve është 30 ditë nga hyrja në fuqi e ligjit. Ligji ka hyrë në fuqi më datë 08.10.2016. Nga kjo rrjedh se periudha për të cilën duhen deklaruar faktet është 08.10.2006 deri në datën 08.10.2016, brenda 30 ditëve nga hyrja e ligjit në fuqi. Ndaj revokimi i vizës në datën 26.01.2017 ka ndodhur jashtë periudhës së parashikimit ligjor për t’iu përgjigjur.

**42.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, nga trupi gjykues në Kolegji vërehet se subjekti i rivlerësimit në këtë shkak ankimor ka një devijim nga mbrojtja e tij nëpërmjet ankimit, pasi në shkaqet e mësipërme shpjegon se revokimi i vizës nuk ka qëllime penalizuese dhe se nuk ka asnjë fakt për të treguar dhe, si rrjedhojë, edhe për të ndryshuar deklaratën e kontrollit të figurës që mban datën 16.01.2017, ndërsa në këtë shkak ankimor subjekti bën përlllogaritje të 10-vjeçarit, faktet e të cilit duhen cituar në deklaratën e kontrollit të figurës, duke e nxjerrë tashmë jashtë afatit detyrimin për deklarinimin e faktit të revokimit të vizës. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi logjikshëm përgjigjja e pyetjes – *Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?* – lidhet me datën e dorëzimit të deklaratës dhe duhet të përputhet me gjendjen e të dhënave të deklaruara në faqet e tjera të deklaratës së kontrollit të figurës.

**42.2** Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli, bazuar në nenin 10, pika 3, germa “c” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

---

*Koordinimit të Departamentit (CA/VO/SAC), agjencitë e transportit në atë vend dhe pikën/at përkatëse të hyrjes të menaxhuara nga Departamenti i Sigurisë së Brendshme (DHS). Njoftimi i Departamentit bëhet në formatin e shpjeguar [...]”.*

<sup>8</sup> Për më shumë, shih: FAM 403.11-4(C)(2) (U) Diplomatic and Official Visas

(CT:VISA-1; 11-18-2015) “[...] (U) Vini re që shumica e kategorive të vizave A, G, C-2, C-3 dhe të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) përjashtohen nga shumica e dispozitave të mospranueshmërisë sipas INA 212(a) sipas 22 CFR 41.21(d). [...]”

ka dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë, më datë 16.01.2017, një formular vetëdeklarimi sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (në vijim ligji nr. 115/2016), formulari i cili për nga forma, përmbajtja dhe procedura e trajtimit të tij, është i ndryshëm nga “Deklarata e kontrollit të figurës” që është paraqitur personalisht nga subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli në DSIK më datë 27.01.2017. Trupi gjykues i Kolegjit ka konstatuar se në nenin 276, pika 1 e ligjit nr. 115/2016, parashikohet se gjyqtarët të cilët shprehin interesin për të kandiduar për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, paraqesin pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dokumentacionin për rivlerësimin, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe, në rast se Komisioni nuk është krijuar ende, kërkesa depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Si rrjedhojë, arsyetimi mbi të cilin Komisioni ka hedhur poshtë këtë argument të subjektit të rivlerësimit nuk është i saktë.

*Sa i përket pretendimit të subjektit, për shkakun ankimor, lidhur me periudhën e plotësimit të deklaratës, nuk është i bazuar.*

43. Subjekti pretendon se përfundimi i shumicës së trupit gjykues në Komision është krejtësisht i paarsyeshëm, në shkelje të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe shkelje flagrante e nenit 38, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Pasaktësia e deklaramit nuk konkurren me fshehjen e fakteve dhe është në kundërshtim me parashikimet e normave kushtetuese, pasi njëri koncept përjashton tjetrin.

43.1 Trupi gjykues i Kolegjit, duke analizuar shkakun e mësipërm, konstaton se subjekti, duke e dorëzuar personalisht formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, të plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e pjesës 5, germa “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, ka fshehur fakte të ndodhura më parë. Situata faktike kjo që, në përputhje me kërkesat e nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, përcakton papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës. Me të drejtë, Komisioni ka arsyetuar, mbështetur nga dokumentacioni i administruar, se te formulari i deklaramit të kontrollit të figurës në pjesën “Të dhëna për sigurinë” nuk janë paraqitur faktet siç janë në realitet dhe koherencë me datën 27.01.2017, që është edhe data e dorëzimit të formularit nga ana e subjektit pranë DSIK-së. Për saktësinë e deklaramit, si dhe paraqitjen e vërtetë të fakteve sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk kishte asnjë pengesë të plotësonte, pasi është në formë elektronike, një formular të ri të deklaramit të kontrollit të figurës për paraqitjen me saktësi dhe vërtetësi të fakteve të ndodhura pas datës 16.01.2016. Ndërkohë që, me nënshkrimin e deklaratës së kontrollit të figurës, prezumohet se ankuesi ka qenë i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Si ditë deklarami, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, konsiderohet data e dorëzimit të deklaratës në DSIK dhe jo data që mban deklarami.

*Për sa më sipër, pretendimi i subjektit, lidhur me këtë shkak ankimor, nuk është i bazuar në fakte e në ligj.*

44. Subjekti pretendon se lidhur me pamjaftueshmërinë e deklaramit, sipas përfundimit të shumicës së trupit gjykues në Komision, nuk është konstatuar asnjëherë dhe nuk i është njoftuar atij. Në formularin e deklaramit të kontrollit të figurës, nuk ka asnjë vend bosh dhe të paplotësuar, çka trupi gjykues e ka pasqyruar edhe në vendimin përfundimtar në pikën 1.4, ku shprehet se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli e ka paraqitur të plotësuar formularin për kontrollin e figurës.

44.1 Në analizë të shkakut ankimor të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se pamjaftueshmëria e deklaramit në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të lidhet vetëm me lënien e vendeve bosh në formularin e deklaramit përkatësisht sipas kriterit, por ka të bëjë me plotësimin e formularit në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, që në momentin

e vlerësimit nga grupet e kontrollit të konkludohet në lidhje me përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Në raportin e rishikuar të DSIK-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.03.2018, rezulton se në përfundim grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli ka evidentuar se ky subjekt ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës në pjesën 5, germa “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi në këtë rast e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe me plotësimin jo me vërtetësi të deklaratës së kontrollit të figurës. Pra, në asnjë rast në konkluzionin e tyre, si DSIK, ashtu dhe Komisioni, nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e plotësimit të deklaratës me mosplotësimin fizik të saj.

*Pretendimi i subjektit lidhur edhe me këtë shkak ankimor nuk është i bazuar.*

*- Lidhur me kriterin për kontrollin e figurës, duke iu referuar kërkesave të nenit Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, edhe në Kolegj konstatohet se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe, me të drejtë, Komisioni ka zbatuar prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Rrjedhimisht, meqenëse edhe nëpërmjet ankimit subjekti i rivlerësimit në Kolegj nuk arrin të provojë të kundërtën e fakteve të konstatuara në Komision, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për këtë fakt mbetet në fuqi.*

*Për pasojë, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.*

## **Shkaqet e parashtuara në ankim në lidhje me pasuritë dhe analizimi i tyre**

### **Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 1**

Përshkrimi i pasurisë nr. 1: Banesë me sipërfaqe 260 m<sup>2</sup> dhe 300 m<sup>2</sup> oborr, me vendndodhje të {\*\*\*}, Rruga {\*\*\*}, nr. {\*\*\*}., Tiranë, me vlerë 196.738 euro, fituar me kontratën e ndërtimit nr. {\*\*\*} rep., dhe {\*\*\*}kol., datë 04.06.2007, e paregjistruar në ZRPP.

- Burimi i deklaruar në deklaratën “vetting”: puna nga të ardhurat si avokat dhe paga e bashkëshortes, si dhe nga kredia në shumën 150.000 euro.

- Deklarimi para fillimit të detyrës në datën 01.11.2007 është shtëpi banimi me sip. 260 m<sup>2</sup> + 200 m<sup>2</sup> oborr në {\*\*\*}, Tiranë, me kontratë sipërmarrjeje të papërfunduar, viti 2007, vlera e paguar 150.000 euro, pjesa takuese 100%.

Komisioni ka kaluar barrën e provës për këtë pasuri për: a) pagesën e kësaj prone; b) sipërfaqen e oborrit të kësaj prone; c) kalimin e çmimit të blerjes.

Rezultatet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:

1. Subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

2. Subjekti i rivlerësimit është përprjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

3. Subjekti ka bërë deklaram të rremë në lidhje me deklaratën “vetting”, pasi nuk ka paraqitur si burim për krijimin e kësaj pasurie huan e marrë ortakut të firmës ndërtuese, z. G.S..

4. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

45. Subjekti pretendon se Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka përcaktuar se ILDKPKI-ja ka kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës në përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklaramit. Shumica e trupit gjykues ka shkelur nenin 253 të KPC, duke përmbysur provat e paraqitura nga ILDKPKI-ja, pa arsytuar pse ka ndodhur. Kjo duhej të ndodhte në rastet kur hetimi i ILDKPKI-së nuk do të ishte i plotë dhe i saktë.

45.1 Në analizë të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, duke u nisur nga sa parashikon Kushtetuta dhe ligji për vlerësimin e deklaratës “vetting” dhe të raportit të ILDPKI-së, për konstatimet në këto akte nuk e përjashton Komisionin apo Kolegjin nga kontrolli i tyre, të cilat jo pa qëllim i dërgohen Komisionit nga ILDKPI-ja që nga viti 2003, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 9049. Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe në deklaratën e pasurisë “vetting”, janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërcituara, si Kushtetuta, edhe ligji kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

45.2 Në vazhdim të analizës së mësipërme, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDPKI *mund të përdoren si provë* nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”. Në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratat periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklaratave periodike të pasurisë vlerën e provës (shih paragrafin 42 të vendimit nr. 9 (JR), datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit), ato mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, deklarata “vetting”. Komisioni apo Kolegji, këto deklarata së bashku me provat e tjera i vlerëson në tërësi dhe harmoni me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Përveç kësaj, Komisioni ushtron kontroll edhe mbi aktin administrativ që është raporti i ILDPKI-së, për provueshmërinë dhe vërtetësinë e tij.

*Pretendimi i mësipërm i subjektit, i trajtuar si shkak ligjor, nuk është i bazuar.*

46. Subjekti pretendon se shumica e trupit gjykues në Komision ka bërë një përshkrim të gabuar të fakteve, sipas të cilit “çmimi është paguar totalisht nga subjekti i rivlerësimit”, konstatim i cili sipas ankuesit nuk është korrekt, pasi Komisioni nuk ka vlerësuar nenin 6 të kontratës nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*}kol., datë 04.06.2007. Në të parashikohet se porositësi është i detyruar të paguajë çmimin e kontratës dhe mënyrën e pagesës, e në rast të mospagimit në kohë, porositësi do t’i paguajë sipërmarrësit një kamatë vonese prej 500 eurosh, për vonesat deri në 30 ditë, çka tregon që pagesa nuk ka qenë e menjëhershme.

46.1 Në analizë të shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, me të vërtetë në nenin 6 të kontratës “Për ndërtim vile”, me nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*}kol., datë 04.06.2007, parashikohet kamatëvonese që rëndon mbi porositësin, në rast se nuk do të paguante këstin në kohë, por me 30 ditë vonesë, prej 500 eurosh, por nga ana tjetër në nenin 3 të kësaj kontrate parashikohet se palët bien dakord për çmimin e sipërmarrjes (është përcaktuar çmimi i vilës, i tokës dhe i pishinës në një total prej 196.738 eurosh), çmim *i cili u pagua me nënshkrimin e kësaj kontrate*, citohet në fund të totalit të vlerës së ndërtimit, çka do të thotë se kushtet e nenit 6 të kontratës mbeten pa ndonjë efekt, pasi këto kushte as nuk janë vërtetuar dhe as nuk kishin se si të vërtetoheshin për sa kohë palët kontraktore kanë nënshkruar se çmimi i vilës është paguar në momentin e nënshkrimit të saj. Për me tepër, neni 3 i kësaj kontrate përkon edhe me deklarinë që ka bërë subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2007,

ku të njëjtën pronë, me të njëjtën vlerë e deklarën “paguar 195 mijë euro”. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit edhe nëpërmjet ankimit për këtë fakt, sa më sipër analizohet, përpiket të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij.

*Vlerësohet se pretendimi i mësipërm i subjektit nuk është i bazuar.*

47. Subjekti ngre si shkak ankimor se shumica e trupit gjykues të Komisionit ka konstatuar gabim faktin që në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti nuk ka deklaruar detyrimin financiar ndaj shoqërisë ndërtuese {\*\*\*}SHPK. Subjekti, si detyrim financiar, i referohet bankës në të cilën është marrë kredi për qëllimin e pagimit të ndërtimit, sipas kontratës lidhur me {\*\*\*}SHPK, por realisht nuk ka pasur asnjë pagim shume nga ana e z. G.S. ndaj dhe nuk ka detyrim konkret ndaj tij. Detyrimi, sipas ankuesit, ishte ndaj bankës Raiffeisen e cila ka disbursuar kredinë në shumën 150.000 euro, sipas kontratës së lidhur.

47.1 Duke analizuar shkakun e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni me të drejtë ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie në deklaratën “vetting” huan e marrë ortakut të shoqërisë ndërtuese, z. G.S.. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “vetting” huan e marrë në bankën Raiffeisen në vlerën 150.000 euro, kredi kjo që ka shërbyer për shlyerjen e huas së marrë më parë ortakut të shoqërisë ndërtuese, z. G.S..

47.2 Në vazhdim të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në nenin 1 të kontratës së kredisë së lidhur me Raiffeisen Bank SHA, me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 08.01.2008, rezulton dakordësia e bankës për t’i dhënë kredinë kredimarrësit në shumën 150.000 euro për përdorim në “Housing”. Nga këto rrethana, rezulton e vërtetuar se burimi i vlerës prej 150.000 eurosh është kredia bankare e deklaruar nga subjekti në deklaratën “vetting”. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo vlerë eurosh ka qenë detyrimi financiar që subjekti i ka pasur ortakut të shoqërisë {\*\*\*} dhe, për pasojë, e gjithë vlera e eurove nga banka i ka kaluar ortakut të shoqërisë. Ky detyrim financiar ka ekzistuar nga momenti i lidhjes së kontratës, më datë 04.06.2007, deri në momentin e likuidimit të ortakut të shoqërisë {\*\*\*}, më datë 04.02.2008, pas disbursimit të kredisë nga banka. Këtë detyrim financiar subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar, edhe pse e kishte detyrim ta bënte në deklaratën para fillimit të detyrës, të cilën e ka plotësuar më datë 01.11.2007, kohë në të cilën ekzistonte detyrimi financiar ndaj shoqërisë {\*\*\*}. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit edhe nëpërmjet ankimit për këtë fakt, sa më sipër analizohet, përpiket të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij.

47.3 Në vijim të analizës së të njëjtës shkak ankimor, arsyetohet:

Në nenin 4 të ligjit nr. 9049, në germën “dh” të tij, objekt i deklarimit janë: “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”. Duke u nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke e lidhur këtë me faktin se subjekti i deklarimit në harkun kohor nga kontrata e parë, që është ajo e ndërtimit, deri te kontrata e dytë, që është ajo e kredisë, ka pasur një detyrim financiar ndaj shoqërisë {\*\*\*} në vlerën 150.000 euro, rezulton se pretendimi i subjektit në ankim nuk është i vërtetë. Ndryshe nga sa pretendon ankuesi në ankim, rezulton se vetë ai në shpjegimet që i ka dhënë Komisionit pas kalimit të barrës së provës (faqe 16 e shpjegimeve të datës 09.07.2018) ka deklaruar: *Sa i takon pjesës tjetër të detyrimit të mbetur, 150.000 euro, me qëllim për të përshpejtuar realizimin e ndërtimit, derisa*

*të lëvrohej efektivisht kredia bankare, u mor përsipër të parapaguhej personalisht nga ana e ortakut, administrator i shoqërisë {\*\*\*}, z. G.S., dhe më pas kjo shumë t'i kalonte atij, sapo ajo të disbursohet nga ana e bankës. Edhe për sa më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit përpiqet të paraqesë në mënyrë të pasaktë mënyrën e krijimit të pasurisë së tij.*

*Sa i përket pretendimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit, përfundimisht vlerësohet se nuk është i bazuar në prova e në ligj.*

48. Subjekti ngre si shkak ankimor se shumica e trupit gjykues në Komision nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për sa kohë nuk janë krijuar elementet e nevojshme që kërkon kjo dispozitë kushtetuese, kalimi i barrës së provës është antikushtetues. Si rrjedhojë, është e nevojshme prania e elementeve faktike që plotësojnë shkakun e përpjekjeve për të fshehur pasurinë në pronësi, posedim apo përdorim, si dhe shkakun e përpjekjeve për ta paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri. Ndaj prezumimi në favor të masës disiplinore dhe kalimi i barrës së provës është i pavlefshëm, për sa kohë nuk janë identifikuar sjelljet e subjektit për të bërë deklaratimet e pasakta, si dhe për të fshehur pasurinë në pronësi, përdorim dhe posedim.

48.1 Duke analizuar shkakun e mësipërm, sipas akteve që gjenden në dosje, provohet:

Rezultatet e hetimit kryesisht në Komision i janë bërë të njohura ankuesit dhe për çdo pasuri është dhënë rezultati i hetimit, duke i kaluar edhe barrën e provës subjektit sipas kërkesave të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Me kalimin e barrës së provës, kuptohet që subjekti duhet të paraqesë prova dhe shpjegime për të provuar bindshëm të kundërtën e asaj çfarë ka konstatuar Komisioni, kur ky i fundit arrin përfundimin se provat kanë nivel provueshmërie sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016. Sa i përket nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, ky është një rezultat i cili vjen në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pasi janë paraqitur pretendimet dhe provat e subjektit në funksion të barrës së provës. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklaratimit me elemente, si: dashja, shkakun apo qëllimin i përpjekjeve për ta paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal) që ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor.

*Sa i përket shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se nuk është i bazuar në ligj.*

49. Subjekti pretendon se Komisioni pa të drejtë ka konstatuar “vlerën e kufizuar provuese” të deklaratës noteriale të bërë nga z. G.S., administratori i shoqërisë {\*\*\*} SHPK, me arsyetimin se ajo është bërë nga njëra prej palëve në kontratë. Gjithashtu, fakti se deklarata është dhënë nga një person që ka marrëdhënie shoqërore me subjektin, nuk duhet të trajtohet si shkak papajtueshmërie për të dëshmuar apo si ndalesë për hyrje në marrëdhënie kontraktore mes të njohurish. Pra, nga njëra anë relatorja dhe shumica e Komisionit e ngarkojnë subjektin me detyrimin e provës për një marrëdhënie dypalëshe, nga ana tjetër nuk pranojnë deklaratimet e palës duke e konsideruar si të pabesueshme.

49.1 Në përgjigje të shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni me të drejtë për hetimin e burimit të krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit është në përputhje të plotë me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, ku sipas nenit 45 të ligjit, anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë

hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. Kjo dispozitë lejon që këto institucione të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes.

**49.2** Në vazhdim të analizës, duke iu referuar nenit 232 të KPC ku parashikohet: “Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës [...]”, vlerësohet se sipas këtij përcaktimi, dëshmia e shtetasit G.S., për të kundërshtuar kushtet e kontratës së ndërtimit nuk lejohet të merret si provë, pasi kontrata përbën një akt juridik me fuqi të plotë provuese, e cila rezulton e lidhur rregullisht nga palët në prani të noterit publik, me vullnetin e tyre të plotë, duke u dakordësuar dhe nënshkruar.

*Sa i përket shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se nuk është i bazuar në ligj.*

- 50.** Subjekti ngre si shkak ankimor se objekti i deklarimeve të tij përpara fillimit të detyrës nuk ka qenë përshkrimi i kohës dhe i mënyrës së pagimit, por tregimi i vlerës së përafërt të pasurisë. Deklarimi fillestar përpara detyrës nuk ka pasur për objekt as deklarin e mënyrës së pagesës dhe as kohën e saktë të pagimit të çmimit, por vetëm deklarin e vlerës së objektit të porositur. Kjo deklaratë nuk kërkonte as detaje, as dokumente shoqëruese, madje as sa i përket periudhës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit. Ndaj, në ankimin e tij subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka bërë asnjë ndryshim në deklarin e shpjegimet e tij në seancë apo në korrespondencat me Komisionin. Si rrjedhojë, subjekti nuk ka marrë asnjëherë hua, që ky t’ia paguante shoqërisë, por dhe të kishte detyrimin ta deklaronte.

**50.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, nga trupi gjykues në Kolegji konstatohet se, në deklaratën para fillimit të detyrës, në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë, pasurive të paluajtshme dhe pasurive të luajtshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë në fjalë, me kontratë sipërmarrjeje të papërfunduar, dhe në rubrikën “vlera me shifra dhe fjalë” ka vënë shumën 195 mijë euro. Ndërsa huaja nga banka Raiffeisen nuk ishte gjeneruar ende në datën e dorëzimit të deklaratës, e cila është 01.11.2007, pasi kontrata e kredisë është lidhur më datë 08.01.2008 dhe kredia është disbursuar më datë 10.01.2008 dhe është kaluar në llogarinë e ortakut të shoqërisë {\*\*\*}, më datë 04.02.2008. Por problemi nuk qëndron në deklarin e vlerës në këtë deklaratë, por në mosdeklarin e detyrimit financiar që subjekti i kishte ortakut të shoqërisë {\*\*\*}. Fakt ky i vërtetuar dhe i njohur si detyrim i subjektit që ta deklaronte para fillimit të detyrës. Kërkesat ligjore të kohës dhe konkretisht neni 4 i ligjit nr. 9049, në germen “dh” të të cilit parashikohet se objekt i deklarinit janë edhe: “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”, si edhe fakti se deklarimi i vitit 2007 nuk i përket periudhës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit, nuk e mbështesin këtë shkak ankimi të subjektit të rivlerësimit.

*Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar në prova e në ligj.*

- 51.** Subjekti pretendon se konstatimi i shumicës së trupit gjykues në Komision, sipas të cilit “aprovimi në parim i kreditimit nuk e ngarkon as bankën, as klientin me detyrimin për nënshkrimin e kontratës së kredisë” është në kundërshtim me provat dhe ligjin. Subjekti thotë se nuk është përmendur në asnjë rast “aprovimi në parim”, por aprovimi përfundimtar i kredisë. Shumica e trupit gjykues në Komision, pretendon subjekti, nuk kanë arritur të arsyetojë shkakun e derdhjes së disbursimit të bankës në llogarinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë. Nëse qëllimi do kishte qenë për të fshehur pasuri me këtë veprim, nuk kishte pse të bëhej me veprime bankare lehtësisht të gjurmueshme, si dhe të deklarohesh periodikisht.

**51.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, trupi i gjykues i Kolegjit, ndryshe nga qëndrimi i Komisionit, vlerëson se kredia është kontraktuar më datë 08.01.2008, ndërmjet bankës dhe



subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, çka kupton rënien dakord për kushtet e kontratës dhe kryesisht dhënien e huas kundrejt pagimit të saj me këste dhe interesa sipas përcaktimeve të kontratës, duke iu referuar kushteve të bankës me të cilën është lidhur kontrata. Më tej, më datë 10.01.2008, shuma e kredituar prej 150.000 eurosh ka kaluar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, duke ekzekutuar *de facto* dhënien e huas. Nuk rezulton në asnjë akt shkresor aprovimi në parim i kredisë para datës 08.01.2008, përveç lidhjes së kontratës *de jure* dhe kalimit të shumës nëpërmjet llogarisë bankare nga kredimarrësi te ndërtuesi.

*Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me aprovimin në parim të kontratës së kredisë është i bazuar.*

**51.2** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton faktin se, nga analiza financiare e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në harmoni me provat që janë administruar ne Komision, gjatë vitit 2007 për këtë pasuri është likuiduar vetëm kësti i parë, 46.738 euro, dhe si pasojë e kësaj analize, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, rezulton se subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të mbuluar pagimin e këstit të parë të pasurisë nr. 1.

*- Lidhur me pasurinë e mësipërme të trajtuar si pasuria nr. 1, trupi gjykues i Kolegjit, në analizën e shkaqeve të ankimit në raport me vendimin e Komisionit dhe provat që janë administruar në Komision, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, situatë faktike kjo që në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

*Për pasojë, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë dhe, rrjedhimisht, sipas kësaj dispozite ka disponuar me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli.*

## **Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 2 dhe analizimi i tyre**

Përshkrimi i pasurisë nr. 2: Kati i parë i një banese dykatëshe, me sip. 188 m<sup>2</sup> dhe oborr me sip. 337,25 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën {\*\*\*}, nr. {\*\*\*}, Tiranë.

Objekt i shqyrtimit administrativ është trualli me sip. 35,12 m<sup>2</sup>, sipas kontratës me nr. {\*\*\*} prot. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2016, që është truall funksional i banesës dykatëshe.

- Burimi i deklaruar për banesën në deklaratën “vetting”: të ardhurat nga paga e subjektit dhe të ardhurat e prindërve; kontratë dhurimi, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.07.1994, me anë të së cilës N., D. dhe N. Zeneli i dhurojnë Artan Zenelit pjesët e tyre takuese të apartamentit.

- Në deklaratën “vetting”, ankuesi nuk e ka deklaruar pjesën e bashkëpronësisë së truallit me 3/12, truall që e ka blerë sipas kontratës me nr. {\*\*\*} prot. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2016. Më pas, më datë 14.02.2017, me kontratën nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., ankuesi ka blerë edhe 3/12 pjesë takuese të këtij trualli nga dy bashkëpronarët e tjerë, duke zotëruar tashmë ½ pjesë takuese të tij.

Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për këtë pasuri, për mosdeklarimin e shtesës së krijuar në datën 22.09.2016, pra përpara datës së dorëzimit të deklaratës “vetting”, më 30.01.2017.

Rezultatet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:

*1. Subjekti ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.*

*2. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.*

52. Në lidhje me pasurinë e sipërcituar, subjekti pretendon në ankim: Fakti që nuk e ka deklaruar pasurinë shtesë me pjesë takuese prej 3/12 e 35,12 m<sup>2</sup> sipërfaqe bashkëpronësie në deklaratën “vetting”, nuk përbën fshehje të kësaj pasurie, pasi neni 3 i ligjit nr. 84/2016 nuk jep përkufizimin e termit “fshehje pasurie”. Fakti që subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklarinimin periodik të vitit 2017 provon faktin që nuk ka dashur ta fshehë këtë shtim pasurie. Gjithashtu, subjekti pretendon në ankim se nuk është marrë vetë me procedurat e shitjes dhe regjistrimit, ndaj për këtë arsye ka harruar ta deklarojë shtesën e pasurisë prej 8,7 m<sup>2</sup>, por jo për qëllime fshehjeje.

52.1 Duke analizuar shkaku e sipërcituar, në referencë të neneve 30 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shtojcës 2 bashkëlidhur ligjit nr. 84/2016, ku subjekteve u kërkohet deklarimi me saktësi dhe vërtetësi i pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin dhe personat e lidhur të tyre, nga trupi gjykues i Kolegjit arsyetohet se për sa kohë që ligji nuk e ka parashikuar harresën apo ndonjë formë tjetër pakujdesie si përligjje të mosdeklarimit të pasurisë, aq më tepër në plotësimin e një formulari, kontrolli i të cilit mund të afektojë vazhdimësinë e karrierës së një gjyqtari, me të drejtë arrihet në konkluzionin e Komisionit se subjekti është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij.

52.2 Në vazhdim të analizës, subjekti i rivlerësimit, sipas certifikatës së pronësisë së datës 25.10.2016, me nr. 1390691, ka të regjistruar pasurinë me nr. 3/461, në rrugën {\*\*\*}, me sipërfaqe 35,12 m<sup>2</sup>, tek e cila zotëron 3/12 pjesë takuese dhe është bashkëpronar me katër persona të tjerë. Trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se, për sa kohë ankuesi kishte nënshkruar kontratën e blerjes së truallit më 22.09.2016, nuk kishte si të harronte më datë 30.01.2017 të deklaronte këtë pasuri. Në deklaratën “vetting”, ankuesi rezulton se nuk ka deklaruar shtesën e truallit prej 3/12, të cilën ua ka blerë bashkëpronarëve të tjerë.

52.3 Trupi gjykues i Kolegjit, duke marrë shkak nga ankimi i subjektit, konstaton gjithashtu se nga analiza financiare për këtë pasuri, në periudhën kur është blerë pasuria nr. 2, për shkak të shpenzimeve të larta të udhëtimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet në vitin 2016, në vlerën 407.305 lekë. Si rrjedhojë, subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme për të blerë pronën e mësipërme në vlerën 41.142 lekë, që korrespondon me vlerën e 3/12 pjesë të vlerës totale prej 164.569 lekësh, që është çmimi i blerjes së truallit prej 35,12 m<sup>2</sup>.

*- Lidhur me pasurinë nr. 2, trupi gjykues i Kolegjit, në analizën e shkaqeve të ankimit në raport me vendimin e Komisionit dhe provat që janë administruar në Komision, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me vlerë 41.142 lekë me burimet e deklaruara dhe me burimet e provuara nga subjekti dhe personi i lidhur, situatë faktike kjo që në përputhje me nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rezulton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka kryer fshehje të pasurisë, situatë faktike kjo që në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 33, pika 5, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

*Për pasojë, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për pasurinë dhe, rrjedhimisht, sipas kësaj dispozite, ka disponuar me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli.*

## Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 3 dhe analizimi i tyre

Përshkrimi i pasurisë nr. 3: Apartament banimi me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, me adresë rr. {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, kati i dytë, Tiranë, me vlerë 41.000 USD në bashkëpronësi.

- Burimi i krijimit të kësaj pasurie, deklaruar në deklaratën “vetting”: të ardhurat nga puna si avokat dhe paga e bashkëshortes.

Blerja e apartamentit është deklaruar në periudha të ndryshme: a) në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2007 deklarohet se është blerë në vitin 1999 me vlerë 41.000 USD; b) në deklaratën “vetting” është deklaruar se është blerë në vitin 2000 dhe se është paguar me këste deri në vitin 2004.

- Pas kalimit të barrës së provës ankuesit, në lidhje me sqarimin e periudhës së blerjes të apartamentit, gjithashtu edhe në lidhje me çmimin e tij, në Komision ka rezultuar edhe se nuk justifikohet blerja me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Rezultatet e Komisionit lidhur me këtë pasuri janë:

1. Subjekti nuk ka deklaruar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

2. Subjekti ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

3. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

53. Subjekti pretendon se shumica e trupit gjykues, pa arsyetuar, ka konsideruar të panevojshme dëshminë e z. A.GJ., administratorit të shoqërisë {\*\*\*}. Ishte e rëndësishme marrja e dëshmisë së tij, për të konfirmuar vazhdimin e marrëdhënies dhe pagimin e çmimit në kohë, ndaj refuzimi i marrjes së dëshmisë dhe i deklaratës noteriale është i paligjshëm.

53.1 Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se lidhur me pretendimin e subjektit për dëshminë e z. A.GJ. dhe deklaratën noteriale që subjekti ka paraqitur me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 05.07.2018, Komisioni ka vlerësuar se kjo deklaratë ka vlerë të kufizuar provuese për shkak se është bërë nga njëra nga palët pjesëmarrëse në kontratë dhe një person me marrëdhënie shoqërore me subjektin e rivlerësimit, por njëkohësisht është realizuar me kërkesën e vetë subjektit. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me dëshminë e z. A.GJ., të konsideruar të panevojshme nga Komisioni, mban të njëjtin qëndrim si në paragrafin 49.2 të arsyetimit të këtij vendimi. Përveç sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje, nuk u gjet asnjë e dhënë apo dokument tjetër që të mbështetë deklaramet e z. Gj., të parashtruara në deklaratën noteriale të cituar më sipër.

*Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.*

54. Subjekti pretendon, ashtu siç ka deklaruar edhe z. A.GJ. në deklaratën noteriale, se apartamenti i banimit në fjalë është likuiduar me këste. Në vitin 1999, kur është lidhur kontrata me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., ka parapaguar shumën 8.000 euro dhe pjesa tjetër prej 33.000 eurosh është paguar nga administratori i shoqërisë, z. Gj., për t’ia likuiduar subjekti i rivlerësimit me këste. Subjekti pretendon se këto këste janë paguar në këtë mënyrë: në vitin 2000 - paguar 4.000 euro, në vitin 2001 - paguar 4.000 euro, në vitin 2002 - paguar 4.000 euro dhe në vitin 2004 - paguar 21.000 euro. Kolegji në analizën e tij nuk i është referuar raportit të sipërcituar, por analizës financiare të kryer në Kolegj.

54.1 Në analizë të shkakut të mësipërm, bazuar në kontratën e shitjes me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 27.05.1999, të lidhur ndërmjet blerësit Artan Zeneli dhe shitësit shoqëria ndërtimore {\*\*\*}, në faqen 3 të kësaj kontrate, pasi nuk është e organizuar në nene, citohet dhe është rënë dakord ndërmjet palëve se *çmimi i shitblerjes është caktuar 41.000 USD, shumë të cilën blerësi ia ka likuiduar totalisht shitësit jashtë kësaj zyre.* Në këtë rast, kemi një kontratë

të nënshkruar me marrëveshje dhe vullnet të plotë para noterit, e cila ka përcaktuar qartë kushtet e shitblerjes dhe likuidimit të çmimit. Nga ana tjetër, nuk kemi asnjë dokument tjetër të llojit kontratë, fatura likuidimi apo fatura banke, të cilat të kundërpeshojnë këtë kontratë shitjeje për mënyrën e pagesës së pronës.

*Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.*

55. Subjekti ka paraqitur raport auditimi të shoqërisë {\*\*\*}, të ekspertit të licensuar, z. T.Gj., dhe pretendon që për vlerat e përlllogaritura, t'i referohemi këtij raporti auditimi, duke besuar në saktësinë dhe korrektësinë e tij.

55.1 Në këtë raport janë kryer përlllogaritje të shpenzimeve të ndryshme por në asnjërin nga këto veprime nuk janë dhënë shpjegime të metodologjisë së përdorur për mënyrën dhe rezultatin e arritur dhe aktet mbi të cilat mbështet ky raport. Për hartimin e këtij akt raporti, eksperti është bazuar kryesisht në deklaramë të subjektit, duke marrë të mirëqena shpjegimet dhe pohimet e tij. Kolegji në analizën e tij, nuk i është referuar raportit të sipërcituar, por analizës financiare të kryer në Kolegj.

55.2 Ne vijim të analizës, lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, rezulton që të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes deri në vitin 1999 janë 2501.307 lekë. Apartamenti është blerë 41.000 USD, vlerë e cila e konvertuar në lekë me kursin përkatës të vitit 1999 është 5539920 lekë. Duke zbritur nga të ardhurat e mësipërme të akumuluar deri në vitin 1999, vlerën e blerjes së shtëpisë të konvertuar në lekë, kemi një diferencë negative prej 3038613 lekësh. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurisë prej 41.000 USD në vitin 1999.

- *Lidhur me pasurinë e mësipërme, nr. 3, në analizën e shkaqeve të ankimit në raport me vendimin e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Situata faktike kjo që bie në kundërshtim me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

- *Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramë të pamjaftueshme për pasurinë.*

- *Bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me vlerë 41.000 USD, me burimet e deklaruara dhe me burimet e provuara nga vetë subjekti.*

*Situata faktike këto që, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

#### **Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 4 dhe analizimi i tyre**

Përshkrimi i pasurisë nr. 4: Apartament banimi me sipërfaqe 212 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rr. {\*\*\*}, pall. {\*\*\*}, Tiranë, me vlerë 100.000 USD, fituar me kontratën e sipërmarrjes datë 15.11.2002 (nuk ka nr. rep., as nr. kol., por është bërë autentifikimi i nënshkrimit para noterit Violeta Sulka), e regjistruar në ZRPP me certifikatën nr. 1660603, më datë 15.05.2017, sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 11.05.2017.

- Burimi i deklaruar në deklaratën "vetting": të ardhurat nga puna si avokat dhe paga e bashkëshortes (paguar me këste).

- Në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2007, subjekti e ka deklaruar apartamentin me sipërfaqe 213 m<sup>2</sup>, rr. {\*\*\*}, pall. {\*\*\*}, Tiranë, me vlerën 100.000 USD, e paregjistruar, me kontratën e sipërmarrjes të vitit 2002.

Në Komision ka rezultuar mospërputhje në lidhje me sipërfaqen dhe numrin e apartamenteve në këtë godinë, si dhe mospërputhje në lidhje me mënyrën e pagesës dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme. Për këtë iu kalua subjektit barra e provës, nga e cila u provua e kundërta

vetëm për sipërfaqen e apartamentit dhe jo për mënyrën e pagesës, si dhe pamjaftueshmërinë e burimeve për këtë pasuri.

Rezultatet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:

*1. Subjekti nuk ka deklaruar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

*2. Subjekti ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.*

*3. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.*

- 56.** Subjekti ngre si shkak ankimor se shumica e trupit gjykues në Komision e ka marrë të mirëqenë faktin se të gjitha pagesat e kësteve për këtë pasuri janë bërë sipas kontratës së sipërmarrjes, në një kohë që të gjitha veprimet juridike dhe provat vërtetojnë se këstet e pagesave janë ndryshuar me marrëveshje mes palëve. Ndaj subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë pagesa të menjëhershme as në shpjegimet dhe argumentet e paraqitura me shkrim, as në shpjegimet gjatë seancës.

**56.1** Në analizë të shkakut të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit, duke iu referuar dokumentacionit që gjendet në dosje, konstaton se më datë 15.11.2002, është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes ndërmjet subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli me cilësinë e porositesit dhe sipërmarrësit, z. P.F., për ndërtimin e një apartamenti me sip. 212,66 m<sup>2</sup>. Çmimi i përcaktuar në këtë kontratë është 100.000 USD, i cili sipas kësaj kontrate do të paguhej me këto këste: 1) Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate do të paguhej kësti prej 52.000 USD; 2) kësti i dytë do të paguhej me para në dorë në shumën prej 25.000 USD brenda datës 31.05.2003; 3) kësti i fundit do të paguhej me para në dorë brenda datës 31.01.2004.

**56.2** Subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli, pyetësit që i është dërguar nga Komisioni më datë 20.12.2017, në të cilin i është kërkuar dokumentacion provues për mënyrën e likuidimit të kësaj shume, i është përgjigjur se pagesat janë kryer me këste sipas kontratës së sipërmarrjes dhe se nuk ka dokumentacion (mandate të ruajtura). Pagesat sipas kontratës së sipërmarrjes janë cituar në paragrafin më sipër.

**56.3** Nga aktet në fashikull, rezulton se në shpjegimet që ka dërguar në Komision, pas kalimit të barrës së provës, më datë 09.07.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me z. P.F. ka nënshkruar një aneks kontrate më datë 09.06.2005 (nuk ka nr. rep., as nr. kol., por është bërë autentifikimi i nënshkrimit para noteres, me nr. rep. {\*\*\*}). Ky aneks kontrate përcakton këstet e shlyera që konkretisht janë: 1) shuma e këstit të parë është shlyer në vitin 2002 dhe është 5.000 \$; 2) shuma e këstit që është paguar në vitin 2004 është 47.000 \$; 3) shuma e këstit që është paguar në vitin 2005 është 38.000 \$. Kësti i fundit që mbetet për t'u dorëzuar në vitin 2006, është 10.000 \$. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka dërguar edhe tri mandate të cilat pasqyrojnë tri këstet e para të përcaktuara në aneksin e sipërcituar. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me vlerën provuese të aneksit të kontratës dhe mandateve të paraqitura në Komision pas kalimit të barrës së provës, ka mbajtur në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur qëndrime të ndryshme në Komision, lidhur më këto pagesa këstesh dhe dokumentacionin që provonte pagimin e tyre. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e dërguara për pyetësit e parë, si dhe në shpjegimet e dhëna para kalimit të barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë pasuri, i pandikuar nga shqetësimi për ndonjë pasojë, i është përmbajtur qëndrimit se këstet e pagesës për këtë pasuri dhe mënyra e pagimit të tyre kanë qenë sipas kontratës së sipërmarrjes. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi gjithashtu se në nenin nr. 4 të kontratës së shitblerjes me nr. rep. {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, të datës 11.05.2017, të nënshkruar para noterit publik, pasi presupozohej të kishte një aneks kontrate ndërmjet subjektit dhe z. P.F., përcaktohet se pagesa e çmimit të shitjes së pronës prej 100.000 dollarësh amerikanë, është bërë sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, pra jo sipas aneksit të

kontratës, që pretendohet se ishte veprimi juridik mes palëve që kishte ndryshuar kushtet e kontratës së sipërmarrjes. Trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim tërësor të provave të administruara nuk krijon bindjen se kjo pasuri është paguar me këstet sipas aneksit të kontratës dhe fotokopjeve të mandateve të paraqitura, por vlerëson si të vërtetë mënyrën e pagimit me këste sipas kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së shitblerjes.

*Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pagesa është kryer me këste sipas aneksit të kontratës së sipërmarrjes, nuk është i bazuar dhe bindës.*

57. Subjekti pretendon se lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, nuk mund të vihet në dyshim për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të ligjshme për të cilat ka paguar detyrimet ligjore përkatëse dhe nuk është provuar apo dyshuar paligjshmëria mbi bazën e treguesve të sigurt kundër ligjshmërisë së burimit. Kjo pasuri është vënë jashtë periudhës kur subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar dhe, si rrjedhojë, mungon çdo raport shkakësie i vënies së kësaj pasurie dhe ushtrimit të funksionit sipas nenit 179/b të Kushtetutës.

57.1 Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se situata financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën që i përket pagesës së kësaj prone në vitin 2002, nuk rezulton me burime të mjaftueshme për të blerë këtë pasuri. Lidhur me pretendimin se kjo pasuri është vënë jashtë periudhës kur subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar, është trajtuar në paragrafin 34.1 e vijues më sipër.

*Pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.*

57.2 Gjithashtu, nga analiza financiare e realizuar në Kolegji, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli, për periudhën 1991-2003, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë e krijuar në vlerën 11.596.039 lekë.

*- Lidhur me këtë pasuri, nr. 4, nga trupi gjykues i Kolegjit arrihet në konkluzionin se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

*- Bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja b e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me burimet e deklaruara dhe me burimet e provuara nga vetë subjekti.*

*Situata faktike këto që në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikojnë të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit.*

*Për pasojë, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë dhe, rrjedhimisht, sipas kësaj dispozite, ka disponuar me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli.*

### **Shkaqet ankimore në lidhje me pasurinë nr. 5 dhe analizimi i tyre**

Përshkrimi i pasurisë nr. 5: Apartament me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në {\*\*\*}, Kavajë, kompleksi {\*\*\*}, me vlerë 45.500 euro, fituar me kontratën për ndërtim apartamenti, datë 28.06.2006, nuk mban nr. rep e kol. (autentifikimi i nënshkrimit, bërë para noterit, mban nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol.).

- Burimi i deklaruar në deklaratën “vetting”: kontratë huaje me bankën {\*\*\*}, për kredi në shumën 40.000 euro; të ardhurat nga puna si avokat dhe paga e bashkëshortes.

- Në deklaratën para fillimit të detyrës, të vitit 2007, deklarohet apartament 2 + 1 me sip. 90 m<sup>2</sup> + tarracë 74 m<sup>2</sup> me vlerë 45.500 euro.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar mospërputhje e sipërfaqes së apartamentit. Për këtë, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, i cili nuk provoi të kundërtën.

Rezultatet e Komisionit lidhur me këtë pasuri:

1. Subjekti ka ndërmarrë hapa për të fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

2. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.

58. Subjekti i rivlerësimit pretendon për këtë pasuri se deklarimi ka qenë i saktë, duke iu referuar kontratës dhe planimetrisë të paraqitura si në deklaratën “vetting”, ashtu edhe në deklaramet e vitit 2007, por çështja qëndron në faktin se ambientet funksionale, si: ballkonet, korridoret dhe ambientet e përbashkëta nuk janë përfshirë në sipërfaqen e banimit.

58.1 Duke analizuar shkakun ankimor më sipër, nga trupi gjykues në Kolegj konstatohet se në deklaratën “vetting” subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar apartamentin me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, blerë me kontratën e ndërtimit datë 28.06.2006, ndërsa në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2007, është deklaruar apartament 2 + 1 me sipërfaqe 90 m<sup>2</sup> + tarracë 74 m<sup>2</sup> me vlerë 45.500 euro. Në kontratën për ndërtim apartamenti, e cila mban datën 28.06.2006, të lidhur mes sipërmarrësit shoqëria {\*\*\*} dhe subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, në nenin 1 të saj, me titull “Objekti i kontratës”, citohet: *sipërfaqe apartamenti sipas gen planit bashkangjitur, 1 kënd gatimi, 2 dhoma gjumi, 1 banjo, 1 ballkon dhe tarraca me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup> sipas planimetrisë bashkëngjitur*. Siç rezulton edhe nga kontrata, nuk është përcaktuar qartë sipërfaqja e saktë e apartamentit, por i është referuar genplanit të bashkangjitur kontratës. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në vitin 2007 sipërfaqen e apartamentit 90 m<sup>2</sup>, bashkë me sipërfaqet e përbashkëta të ndërtimit, pavarësisht mospërputhjeve në dokumentacion, pasi edhe prona nuk është e regjistruar.

58.2 Në vijim të analizës, sipërfaqja rezultoi e provuar nga ALUIZNI, i cili i ka kthyer përgjigje Komisionit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2018, sipas së cilës saktësohet se sipërfaqja e apartamentit është 76,4 m<sup>2</sup>; ballkon 12 m<sup>2</sup>; dhe sip. e tarracës 74 m<sup>2</sup>, çka do të thotë se ky fakt përputhet me deklarimin e subjektit të bërë në vitin 2007, sipas të cilit sipërfaqja e banimit është rreth 90 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e tarracës është 74 m<sup>2</sup>. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar këtë shkak ankimor të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk pajtohet me përfundimet e Komisionit për këtë pasuri.

*Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasurinë nr. 5 është i bazuar.*

## V. Konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit lidhur me provat dhe aktet e administruara në këtë çështje, në përfundim të shqyrtimit të vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, arriti në këto konkluzione:

1. Nga analiza ligjore dhe faktike e shkaqeve të ankimit në raport me vendimin e Komisionit, lidhur me kriterin për kontrollin e figurës, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të pavërtetë dhe të pasaktë e jo në përputhje me germën “g” të shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Njëkohësisht, konstatohet se subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me nenin Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës. Rrjedhimisht, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me të drejtë, Komisioni për këtë shkak ka dhënë si masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit Artan Zeneli, shkarkimin nga detyra.

- II. Lidhur me pasurinë e trajtuar si pasuria nr. 1, banesë me sipërfaqe 260 m<sup>2</sup> dhe 300 m<sup>2</sup> oborr, te {\*\*\*}, Rruga {\*\*\*}, nr. {\*\*\*}., Tiranë, me vlerë 196.738 euro, fituar me kontratën e ndërtimit nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*} kol., datë 04.06.2007, e paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, rezulton se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi. Situata faktike kjo që, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.
- III. Lidhur me pasurinë nr. 2, banesë dykatëshe, me sipërfaqe 188 m<sup>2</sup> dhe oborr me sipërfaqe 337,25 m<sup>2</sup>, në rrugën {\*\*\*}, Tiranë, ku pjesë e shqyrtimit gjyqësor është trualli me sipërfaqe 35,12 m<sup>2</sup>, sipas kontratës me nr. {\*\*\*} prot. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2016, në analizën e shkaqeve të ankimit në raport me vendimin e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me vlerë 41.142 lekë me burimet e deklaruara e të provuara nga subjekti dhe personi i lidhur. Situata faktike kjo që në përputhje me nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rezulton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka kryer fshehje të pasurisë, situata faktike kjo që në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, parashikon të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë.
- IV. Lidhur me pasurinë nr. 3, apartament banimi 3 + 1, me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, në rrugën {\*\*\*}, Tiranë, fituar me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 27.05.1999, me vlerë 41.000 USD, rezulton se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Situata faktike kjo që bie në kundërshtim me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë. Bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me vlerë 41.000 USD. Situata faktike këto që në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon të prezumohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
- v. Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore, që i përkasin pasurisë nr. {\*\*\*}, apartament banimi me sipërfaqe 212 m<sup>2</sup>, në rr. {\*\*\*}, pall. {\*\*\*}, Tiranë, me vlerë 100.000 USD, fituar me kontratën e sipërmarrjes datë 15.11.2002, e regjistruar në ZRPP më datë 15.05.2017, sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 11.05.2017, nisur nga përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve, e gjithashtu duke marrë parasysh edhe deklaramet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se për periudhën 1991-2003, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në vlerën 11.596.039 lekë për të justifikuar pasurinë e krijuar. Si rezultat, subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë; si dhe bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i



rivlerësimit Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me burimet e deklaruar dhe të provuara.

- VI. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë vendimin e Komisionit dhe të marrë në bazë e në zbatim të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit Kushtetutës dhe nenit Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit Kushtetutës, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra ndaj subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall në Tiranë, sot, më datë 04.02.2019.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**  
*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**  
*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**  
*nënshkrimi*

#### **RELATOR**

**Ardian HAJDARI**  
*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**  
*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, po parashtroj më poshtë argumentet e një arsyetimi paralel me arsyetimin e vendimit nr. 2 (JR), datë 04.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
2. Arsyetimi i këtij mendimi paralel lidhet me qëndrime të ndryshme në raport me qëndrimin e mbajtur nga trupa gjyquese për disa nga shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, por që nuk afekton qëndrimin tim pro vendimmarrjes së trupës për lënien në fuqi të vendimit nr. 41, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli.
3. Kam mbështetur dhe kam votuar pro argumenteve të dhëna nga trupa gjyquese në analizë të shkaqeve të ankimit të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit. Për pjesën më të madhe të tyre, kam vlerësuar se me të drejtë e kanë çuar të gjithë trupën gjyquese të Kolegjit në konkluzionin se vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi. Pavarësisht kësaj, në vlerësimin tim, disa prej shkaqeve të ngritura në ankim prej subjektit të rivlerësimit qëndrojnë dhe ato duhet të ishin reflektuar në qëndrimin që trupa gjyquese duhet të mbante në raport me arsyetimin dhe shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Më poshtë po jap argumentet e mia për ato shkaqe dhe çështje për të cilat kam ndarë një qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi dhe arsyetimi që ka bërë trupa gjyquese.

### I

5. Kam votuar kundër qëndrimit të mbajtur nga shumica në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Artan Zeneli, duke arsyetuar se në vlerësim të rrethanave të faktit e analizës së kuadrit ligjor, subjekti nuk duhej të konsiderohej se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në zbatim të neneve 39 e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar si më poshtë.
6. Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar se ky konstatim i Komisionit lidhet dhe i atribuohet faktit që subjekti i rivlerësimit në formularin për kontrollin e figurës, në pjesën e të dhënave për sigurinë, pyetjes - Gjatë 10 viteve të fundit, ju është refuzuar ndonjëherë hyrja për në ndonjë shtet të BE/NATO? - i është përgjigjur me "JO". Ky formular është dorëzuar në DSIK në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, më datë 27.01.2017. Ky institucion ka përpiluar raportin për këtë subjekt, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe e ka depozituar atë në Komision më datë 31.10.2017, duke konkluduar për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjektit Artan Zeneli i është revokuar një vizë e tipit B2 për qëllime turistike, e lëshuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës më datë 26.01.2017, vendim i cili i është komunikuar subjektit po këtë ditë. Për shkak të këtij fakti, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së të shprehet përsëri në lidhje me përshtatshmërinë ose jo të tij për vazhdimin e detyrës dhe, në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni, më datë 09.03.2018, ka kthyer përgjigje në të cilën ka konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës

për shkak të deklarimit të pasaktë të kryer në formular dhe ka kryer në këtë kuptim deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke përbërë ky përcaktim një shkak për shkarkimin nga detyra të tij.

7. Pa dashur të përsëris shkaqet që subjekti ka parashtruar në drejtim të këtij konkluzioni të Komisionit, të cilat janë përshkruar në mënyrë të detajuar në vendim, dua të ndalem në analizën e një rrethane të faktit në lidhje me këtë çështje dhe analizën e dispozitave ligjore që në këndvështrimin tim të çojnë në konkluzionin se fakti i pretenduar nuk shkakton plotësim të pavërtetë të formularit dhe as provohet që ai të ketë pasur për qëllim të prezantojë fakte të pavërteta në lidhje me këtë të dhënë në kuptim të nenit Dh pika 4, e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë nuk mund të shërbejë si një shkak për të konsideruar se jemi para një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë i pajisur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara me dy viza, që i mundësonin atij hyrjen në territorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Njëra vizë ishte e tipit B2 për qëllime turistike, kurse tjetra ishte vizë e tipit A1 për qëllime pune, e dhënë për shkak të statusit të anëtarit të Gjykatës së Lartë.
8. Nga hetimi ka rezultuar se Ambasada e Shteteve të Bashkuara i ka revokuar subjektit të rivlerësimit më datë 26.01.2017 vizën e tipit B2, pa u shprehur për vizën e tipit A1, e cila ka qenë e vlefshme deri më 5 qershor 2018, datë në të cilën është refuzuar edhe ajo gjithashtu.
9. Në analizë të këtyre fakteve, mendoj se çështjet që kërkonin zgjidhje për këtë shkak ishin si më poshtë:
  1. Çfarë do të kuptohet me pyetjen që shtrohet në formularin e kontrollit të figurës: “Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO?”
  2. A ndodhej subjekti në kushtet kur *a prima facie* do të duhej të jepte të dhëna për revokimin e vizës së tipit B2?
  3. A gjendemi para situatës së përpjekjes së subjektit për të paraqitur të dhëna të pasakta në funksion të manipulimit të së vërtetës dhe fakteve?
10. Në lidhje me çështjen e parë, në një interpretim literal dhe logjik të pyetjes së shtruar në formularin e kontrollit të figurës, mendoj që pyetja e shtruar duhet t'i referohet pikërisht konceptit të “hyrjes” në një shtet të BE/NATOS, duke qenë se ky koncept përfshin jo vetëm revokimin/anulimin apo refuzimin e një vize nga ambasadat e vendeve respektive, kur një e tillë është e nevojshme për të hyrë në një shtet të BE/NATOS, por përfshin gjithashtu edhe rastet e deportimit apo refuzimit për të hyrë në një shtet të BE/NATOS ku pasja e një vize nuk është e nevojshme apo edhe rastet kur disponohet një vizë e rregullt, e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse dhe, për shkaqe të tjera, individit i refuzohet në zonën kufitare hyrja në atë vend nga autoritetet përgjegjëse.
11. Në vlerësimin tim, ndryshe nga sa arsyeton shumica në vendimin e saj, interpretimi i termit “refuzim hyrjeje” duhet të jetë një interpretim logjik dhe gjuhësor i këtij instituti, pasi interpretimi ligjor i termit “refuzim hyrjeje”, sipas legjislacioneve të vendeve të ndryshme, del nga natyra dhe qëllimi për të cilin është shtruar pyetja në këtë formular. Në gjykimin tim, me “refuzim hyrjeje”, sipas kësaj pyetjeje të shtruar në formularin për kontrollin e figurës do të duhej të kuptohej çdo ndalim i bërë një subjekti për të hyrë në një shtet të BE/NATO, qoftë nëpërmjet revokimit/refuzimit të një vize, qoftë nëpërmjet refuzimit fizikisht të hyrjes në një shtet, në pikën e tij kufitare. Për pasojë, nëse subjekti i rivlerësimit në rastin konkret do të kishte pasur vetëm 1 (një) vizë të dhënë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara për të mundësuar

hyrjen në territorin amerikan e cila të ishte revokuar, ai do të duhej të barazonte këtë revokim me refuzimin për hyrjen në këtë shtet pasi nuk ekzistonte asnjë mundësi tjetër që ai të realizonte hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në situatën kur subjekti i rivlerësimit posedonte një vizë tjetër për të hyrë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilën nuk kishte një njoftim revokimi, hyrja për në këtë shtet në atë kohë për të, në dijeninë e tij, ishte e lejuar dhe nuk ishte refuzuar.

12. Në konkluzion të këtij arsyetimi, gjykoj se instituti i refuzimit të hyrjes në një shtet nuk është i njëjtë me atë të refuzimit/revokimit të vizës, por lidhet me pengesën objektive që një subjekt ka pasur për të hyrë në territorin e një shteti.
13. Në lidhje me çështjen e dytë, në analizë të rrethanave të rastit, mendoj se subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin t'i përgjigjej me "po" pyetjes së shtruar si më lart. Në këndvështrimin tim, subjekti, pavarësisht dijenisë për revokimin e vizës turistike B2, posedonte ende një vizë të vlefshme për qëllime pune të tipit A1, në këtë kuptim ai mund të hynte në territorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës duke përdorur këtë vizë, deri në një provë të kundërt, që do të ishte refuzimi i hyrjes në kufi ose revokimi edhe i vizës tjetër që ai e posedonte si ende të vlefshme. Ndryshe nga sa arsyeton shumica për prezumimin se subjekti duhet të jetë njoftuar prej autoriteteve për pasojat që vijnë nga revokimi i një vize të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe zbatimi konkret i saj, mendoj që në kushtet kur asnjë e dhënë e tillë nuk ka rezultuar nga hetimi, prezumimi në favor të dijenisë së këtyre të dhënave nuk është një rast i aplikueshëm, pasi ligji nuk ka një parashikim të tillë. Pra, vlerësoj se nuk mund të hamendësohen fakte që rëndojnë pozitën e subjektit, për sa kohë që në drejtim të tyre nuk ka asnjë provë të administruar.
14. Në vlerësim të rrethanave të përshkruara më lart, mendoj se subjekti nuk kishte detyrimin t'i përgjigjej me "po" pyetjes për refuzimin e hyrjes. Subjekti mund të kishte detyrim të jepte shpjegime nëse formulari do të ishte konceptuar me rubrika që edhe përshkruajnë situata të caktuara në të cilat do të duhej të parashtronte situatën. Por në kushtet kur përgjigjja sipas formularit ka vetëm dy alternativa, "po" dhe "jo", mendoj se subjekti i ndodhur në kushtet e pasjes së një vize tjetër që i mundësonte në dijeninë e tij hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i është përgjigjur natyrshëm me përgjigje negative pyetjes së shtruar.
15. Në lidhje me çështjen e tretë, mendoj se edhe në rast se do të pranohet që subjekti ka dhënë një përgjigje të pasaktë, pasi ai do të duhej t'i përgjigjej pozitivisht pyetjes së bërë, siç ka konkluduar shumica, kjo nuk do të ishte një rrethanë që do ta çonte subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi në vlerësimin tim i mungon shkaku kushtetues për shkarkim, i parashikuar nga neni Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon: *[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën [...].*
16. Në zbatim të këtij parashikimi, i cili zberthehet më pas në nenet 39, pika 2 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kërkohet që pasaktësitë e konstatuara në formularin e kontrollit të figurës të jenë rezultat i përpjekjes së subjektit të rivlerësimit për të fshehur të dhëna apo për t'i paraqitur

gabimisht ato në funksion të manipulimit të organeve që do të kryejnë kontrollin e figurës dhe arritjes prej tyre në konkluzione pozitive për subjektin e rivlerësimit, pa ditur të gjithë të vërtetat e tij në raport me figurën e lidhjet e tij me kontakte të papërshtatshme. Qëllimi i dispozitës është të ndërgjegjësojë subjektet e rivlerësimit drejt një deklarimi sa më të sinqertë dhe të vërtetë pasi - në rast se të dhënat që ata përpiqen të fshehin, zbulohen - kjo sjellje prezumon shkarkimin e tyre nga detyra. Ligjvënësi është përpjekur, në gjykimin tim, të garantojë nëpërmjet këtij rregullimi mbledhjen e informacioneve sa më të vërteta dhe të plota, veçanërisht për të dhëna që nuk janë lehtësisht të verifikueshme apo të zbulueshme. Një kategori e tillë të dhënash do të ishin natyrshëm ato që nuk lënë domosdoshmërisht gjurmë të natyrës dokumentare dhe zbulimi i të cilave mund të kërkojë një punë hetimore dhe kërkuese specifike. Të tilla mund të jenë lidhjet me persona të papërshtatshëm, frekuentimi i ambienteve në prani të tyre apo aktivitete përgjithësisht të fshehta të subjekteve. Këto lloj të dhënash do tentonin subjektet natyrshëm të mos deklaroinin, me shpresën se organet përgjegjëse nuk do të viheshin në dijeni të tyre dhe, për këtë arsye, norma kushtetuese ka paralajmëruar vigjilencë të lartë në këtë drejtim dhe konsekuencë ekstreme në rast të mosdeklarimit të tyre.

17. E dhëna për të cilën subjekti është konsideruar i papërshtatshëm se nuk e ka deklaruar, lidhet me një informacion lehtësisht të verifikueshëm, nëpërmjet bashkëpunimit normal e të standardizuar për këtë proces të DSIK-së me ambasadat e vendeve të BE/NATO. Madje ky lloj kontrolli ka qenë një politikë e njohur përpara se të kryhej procesi i dorëzimit të formularëve të kontrollit të figurës. Në këtë logjikë, gjykoj se subjekti i rivlerësimit, një funksionar i lartë i shtetit dhe jurist me formim të spikatur, vështirë të kishte iluzione që nëpërmjet mosdeklarimit të kësaj të dhëne në formular, do të arrinte fshehjen e saj. Duke ndjekur një logjikë normale, çdokush që do të donte të fshihte një të dhënë të kësaj natyre, do të duhej të dinte se ajo ishte thjesht e pamundur dhe, për pasojë, sjellja e tij drejt fshehjes do të kthehej krejtësisht kundër interesave të tij, duke e ndëshkuar me shkarkimin nga detyra.
18. Në përfundim të këtij arsyetimi, edhe sikur të prananim se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë duke dhënë përgjigje të gabuar, vlerësoj se asnjë rrethanë nuk provon përpjekjen e tij për ta fshehur këtë të dhënë, për pasojë nuk provohet se ekziston në vlerësimin tim shkak kushtetues i shkarkimit nga detyra.

## II

19. Kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica e trupës gjyquese edhe në lidhje me konkluzionet që lidhen me pasurinë banesë, me sipërfaqe 260 m<sup>2</sup> dhe 300 m<sup>2</sup>, të ndodhur në zonën e {\*\*\*}, Tiranë. Shumica e trupës gjyquese ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, duke bërë deklaram të pamjaftueshëm, në bazë të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ndodhet në një rrethanë që përbën një shkak për shkarkimin e tij nga detyra.
20. Siç pasqyrohet edhe në arsyetimin e vendimit, subjekti i rivlerësimit ka lidhur në datën 04.06.2007 një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë {\*\*\*} SHPK, me ortak të vetëm shtetasin G.S., duke porositur ndërtimin e një vile me një vlerë prej 195 mijë eurosh. Në nenin 3 të kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep e nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2007, është parashikuar se ky çmim është paguar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ndërkohë që në nenin 6 të së njëjtës kontratë parashikohet pagimi i penaltetit prej 500 eurosh për çdo 30 ditë vonesë të pagimit të çmimit të kontratës.

21. Në analizë të deklaratës para fillimit të detyrës, të nëntorit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e mësipërme, duke vendosur te pjesa e vlerës së saj “paguar 195 mijë euro”, pa dhënë detaje apo shpjegime për rrethanat në të cilat është paguar ose jo ky çmim. Më pas, në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie bankare nga Raiffeisen Bank për vlerën prej 150 mijë eurosh, e cila është përdorur për shlyerjen e detyrimit në të njëjtën vlerë ndaj ortakut të shoqërisë {\*\*\*} SHPK, G.S., sipas çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes. Të njëjtin deklaram ka bërë subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* në të cilin ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie 46.738 mijë euro kursime dhe 150 mijë euro kredi bankare. Gjithashtu, vetë shumica e trupës gjykuese në arsyetimin e vendimit, paragrafi 45 i tij, pranon se subjekti ka pasur burime të mjaftueshme në vitin 2007 për të bërë pagesën e 46.738 eurove dhe se diferenca prej 150 mijë eurosh është paguar nëpërmjet disbursimit të kredisë marrë nga Raiffeisen Bank në vitin 2008. Në gjykimin e shumicës, shkak i shkarkimit që lidhet me këtë pasuri, ka të bëjë me mosdeklarimin në vitin 2007, në deklaratën para fillimit të detyrës, nga ana e subjektit të rivlerësimit të huas që ai kishte ndaj ortakut të shoqërisë {\*\*\*} SHPK, shtetasit G.S. për shumën prej 150 mijë eurosh.
22. Ndryshe nga sa ka arsyetuar shumica në lidhje me këtë shkak, vlerësoj se situata e lidhur me këtë pasuri mund të klasifikohet si një deklaram i pasaktë i subjektit të rivlerësimit në kohën e deklarimit të pasurisë para fillimit të detyrës, në të cilën ai nuk ka deklaruar qartazi pagimin ose jo të çmimit të kësaj pasurie, si edhe faktin se një pjesë e tij ishte ende e pashlyer. Subjekti i rivlerësimit e ka sqaruar këtë pasaktësi në deklaratën periodike të vitit 2008, pasi ishte disbursuar edhe kredia prej 150 mijë eurosh dhe në të njëjtën logjikë është bërë edhe deklarimi i burimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*.
23. Në lidhje me këtë situatë, vlerësoj se çështjet që duheshin zgjidhur nga trupa gjykuese në funksion të përcaktimit sa më të saktë të situatës ligjore që lidhet me këtë pasuri, do të ishin:
1. Cili rezulton të jetë burimi i krijimit të kësaj pasurie?
  2. Si duhej deklaruar fitimi i kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës?
  3. A është deklaruar saktë burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*?
  4. Përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit në raport me deklarimet që ai ka bërë në lidhje me këtë pasuri.
24. Në lidhje me çështjen e parë, nga shqyrtimi i të gjitha akteve të administruara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se si burim i krijimit të kësaj pasurie kanë qenë pjesërisht kursimet e krijuara nga të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, në shumën 46.738 euro, të paguara në vitin 2007 me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, dhe shuma prej 150 mijë eurosh, të huazuara nga Raiffeisen Bank nëpërmjet kredisë bankare, të transferuar më pas në emër të ortakut të vetëm të shoqërisë {\*\*\*} SHPK, me disbursimin e kredisë në datën 04.02.2008. Këto fakte janë pranuar si të tilla edhe nga analiza që ka bërë shumica e trupës gjykuese në Kolegj, ndryshe nga arsyetimi që ka bërë Komisioni në përfundim të procesit administrativ. Fakti që në kontratën e sipërmarrjes ka dy dispozita që bien në kundërshtim njëra me tjetrën, për sa i përket momentit të pagimit të çmimit, neni 3 dhe neni 6 të cituar më lart, provokon nevojën për interpretim të kontratës së sipërmarrjes, në zbatim të rregullave të parashikuara në nenet 481- 489 të Kodit Civil në lidhje me interpretimin e kushteve të një kontrate. Në vijim të këtyre dispozitave, vlerësoj se do të prevalojë interpretimi i kontratës në funksion të qëllimit të saj dhe të pasjes efekt të kushteve të saj (nenet 681, 683 të Kodit Civil). Në këto rrethana, deklarimet që ka bërë subjekti i rivlerësimit dhe ortaku i vetëm i shoqërisë, G.S., në lidhje me momentin e shlyerjes së detyrimit, do të analizohen e vlerësohen në raport edhe me këtë kontradiktoritet që pasqyron kontrata për shkak të dualitetit të normave brenda saj. Arsyetimi që neni 253 i Kodit të Procedurës Civile nuk lejon të provohet me dëshmitarë e kundërta e një akti zyrtar, siç është kontrata e sipërmarrjes e nënshkruar para noterit, nuk gjykoj

se është relevant pasi, në vlerësimin tim, shtetasi G.S. nuk është dëshmitar në kuptimin që ky burim prove ka në Kodin e Procedurës Civile, por një nga palët e kontratës e cila natyrshëm mund të japë shpjegime të vlefshme në lidhje me interpretimin e kushteve të një kontrate të nënshkruar prej vetë atij.

25. Për këto arsye, gjendur në përplasjen e kushteve të pasqyruara në kontratë, pretendimi i të dy palëve se e vetmja shumë e paguar me lidhjen e kontratës është ajo prej 46.738 eurosh, gjendet e bazuar. Përveç këtyre shpjegimeve, duhet konsideruar edhe fakti i rëndësishëm se në muajin shkurt të vitit 2008, siç deklarohet prej subjektit të rivlerësimit, është paguar shuma prej 150 mijë eurosh në favor të ortakut të vetëm të shoqërisë {\*\*\*}SHPK, si shumë e papaguar prej çmimit të kontratës së sipërmarrjes. Kjo rrethanë e analizuar së bashku me faktin se midis palëve nuk ekziston asnjë marrëdhënie tjetër, e cila të legjitimonte pagimin e një shume të tillë nga subjekti të shtetasi G.S., të krijoj bindjen se kjo pagesë që është gjeneruar prej akordimit të kredisë prej 150 mijë eurosh, është pjesa tjetër e burimit të krijimit të kësaj pasurie. Në vijim të këtij arsyetimi, e shoh të rëndësishme të sjell në vëmendje konkluzionin e shumicës së trupës gjyquese të Kolegjit se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të paguar në vitin 2007 shumën prej 46.738 eurosh, si pagesë për çmimin e kontraktuar prej 195 mijë eurosh dhe se, gjithashtu, shuma prej 150 mijë eurosh, si diferencë e pagimit të çmimit, vjen nga një burim i ligjshëm financiar, siç është huaja në formën e kredisë bankare, të cilën subjekti vazhdon ende ta shlyejë edhe sot.
26. Në lidhje me çështjen tjetër se si duhej pasqyruar fitimi i kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës, përveç se në vlerësimin tim nuk duhej të ishte një objekt i mirëfilltë verifikimi në funksion të konstatimit të ekzistencës së ndonjë shkaku shkarkimi, por një objekt analize në funksion të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting*, jam dakord me arsyetimin e shumicës që subjekti duhej të kishte deklaruar në këtë deklaratë gjendjen faktike në lidhje me shlyerjen ose jo të detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar çdo akt që prodhonte apo përfaqësonte të dhëna me interes në këtë drejtim. Nga analiza e deklaratës, rezulton se subjekti nuk e ka bërë saktë këtë pasqyrim. Nga shpjegimet që ai ka dhënë gjatë procedurës administrative, ka tentuar të shpjegojë se qoftë aspekti dokumentar që pasqyrore këtë situatë, qoftë shpjegimet e tij nuk kanë qenë të detajuara, edhe për shkak të faktit se kjo pasuri është fituar para se subjekti të behej gjyqtar e madje para se të bëhej subjekt deklarues, edhe për shkak të funksionit tjetër administrativ, siç ishte anëtari i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar (kujtojmë që subjekti është emëruar gjyqtar në vitin 2009 dhe deklarimi para fillimit të detyrës në vitin 2007 lidhet me funksionin e tij si anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH).
27. Në këtë kontekst, mendoj që duhet analizuar edhe sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke zbatuar parimin e objektivitetit të parashikuar si një prej parimeve të sanksionuara në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, mbi të cilat zhvillohet shqyrtimi i çështjes në procesin e rivlerësimit. Ky parim në zbatim të parashikimit të nenit 14 të Kodit të Procedurës Administrative, sipas të cilit: [...] *Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative [...]*, detyron organet e *vetting*-ut të konsiderojnë të gjitha rrethanat që shoqërojnë një çështje të caktuar, duke i çmuar me objektivitet ato dhe mënyrën se si ato kanë ndikuar në sjelljen e subjektit të rivlerësimit.

28. Në këtë kuptim, duke mos qenë një subjekt deklarues në kohën e hartimit të kësaj kontrate dhe të përcaktimit të detyrimeve reciproke mes palëve, ai nuk ishte i detyruar të tregonte kujdesin maksimal që i duhet të tregojë një individ i cili hyn në një marrëdhënie të caktuar juridiko-civile, duke qenë subjekt deklarimi sipas ligjit. Në vlerësimin tim, pikërisht nga ky status i subjektit vjen edhe paqartësia e përcaktimit të pagimit të çmimit prej 150 mijë eurosh, duke e quajtur atë si një hua të ortakut G.S., ndërkohë që në thelb kjo rrethanë do të duhej të kualifikohej si një detyrim i pashlyer ende në drejtim të shoqërisë. Në këtë konkluzion arrij duke pasur në konsideratë edhe faktin se nuk ka rezultuar asnjë marrëdhënie huamarrjeje mes subjektit e shtetasit G. S., e hartuar sipas kërkesave të ligjit, por gjendja faktike duket se është trajtuar si një marrëdhënie huaje prej Komisionit dhe Kolegjit. Në këtë situatë ndikon gjithashtu edhe fakti se ortaku G.S. është ortaku i vetëm, pra organi i vetëm vendimmarrës dhe administrator i shoqërisë {\*\*\*}SHPK, e cila ka qenë e regjistruar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kjo situatë ligjore, por edhe kultura e funksionimit të shoqërive të tilla në vendin tonë në kohën për të cilën flasim, vitin 2007, tregon për një mungesë qartësie në drejtim të përgjegjësisë dhe të drejtave të palëve të përfshira në marrëdhënie juridiko civile me shoqëri të tilla, aq më tepër kur në këto marrëdhënie përfshiheshin edhe raportet shoqërore (siç pranohet nga Komisioni) që ka pasur subjekti me shtetasin S.. Në rast se do të pranohet realisht që marrëdhëniet mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit G.S., në lidhje me shumën prej 150 mijë eurosh, do të ishte një marrëdhënie huaje, do të duhej të pranohet gati një alogjizëm, sipas të cilit ortaku i vetëm dhe administratori i shoqërisë i ka dhënë hua subjektit, që ky i fundit të shlyente detyrimin që i kishte shoqërisë {\*\*\*}SHPK, që me gjithë personalitetin e ndryshëm juridik nga vetë ortaku i saj, praktikisht barazohet me ortakun për të gjitha arsyet që përmenda më lart.
29. Për këto arsye, vlerësoj se përcaktimi i saktë ligjor i situatës faktike që rezulton se ka ekzistuar mes këtyre palëve, në drejtim të pagimit të vlerës prej 150 mijë eurosh, është një detyrim i pashlyer ndaj shoqërisë {\*\*\*} SHPK, në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, detyrim i cili është shlyer me disbursimin e kësaj shume, pas miratimit të kredisë, në favor të ortakut G.S.. Përcaktimi i saktë i fakteve dhe i veprimeve të palëve të përfshira në një proces është një e drejtë dhe detyrim i gjykatës, në zbatim të nenit 16, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile.
30. Në lidhje me çështjen e tretë, duke ndjekur përfundimin e arritur më sipër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pasurisë në fjalë, duke përcaktuar kursimet nga të ardhurat personale në shumën 46.738 euro dhe kredinë në shumën prej 150 mijë eurosh si burime të krijimit të kësaj pasurie. Nga hetimi nuk ka rezultuar përdorimi i ndonjë burimi tjetër për të krijuar këtë pasuri, dhe huaja e konkluduar si e tillë nga shumica, në vlerësimin tim nuk ka qenë gjë tjetër veçse shlyerja e detyrimit në një kohë tjetër nga lidhja e kontratës, dhe që lidhet me disbursimin e kredisë.
31. Në lidhje me çështjen e katërt të shtruar për zgjidhje, vlen të nënvizohet fakti se pavarësisht deklarimit të pasaktë të subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës, në lidhje me mosshlyerjen e vlerës së çmimit për këtë pasuri, ky element është pasqyruar në vlerësimin tim saktë në deklaratën *vetting*. Në këto rrethana, deklarimi i pasaktë i vitit 2007, për më tepër i pashoqëruar me ndonjë të dhënë që tregon për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, siç pranohet edhe nga shumica e trupës gjyquese, në vlerësimin



tim nuk tregon për përpjekjeje të subjektit për të pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi të tij. Rregulli kushtetues i përpjekjeve për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, kërkon ekzistencën e një shkakut të arsyeshëm që detyron subjektin të adaptojë këtë lloj sjelljeje me deklaratimet që kryen. Në rastin konkret, nuk rezulton nga hetimi asnjë motiv që në mënyrë të logjikshme do të kishte detyruar subjektin e rivlerësimit të paraqiste në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi dhe të rrezikonte shkarkimin nga detyra. Mbi të gjitha, në analizën e situatave, të kategorizuara mbi bazën e këtij përkufizimi kushtetues, do të duhej të dominonte mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë ose nevojat për të qenë konsekuent me ndonjë deklaratim të mëparshëm që mund ta vinte subjektin në pozitë të deklarimit të rremë ose fshehtësisë së pasurisë. Për sa kohë që në rastin konkret subjekti nuk rezulton të gjendet në ndonjë nga këto situata, mendoj që nuk mund ta konsiderojmë këtë sjellje të tij si deklaratim të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33 e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk plotësohen rekuizitat që kërkon neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, për konstatimin e përpjekjeve në funksion të një qëllimi manipulativ të organeve të rivlerësimit.

### III

32. Kam votuar gjithashtu kundër qëndrimit që ka mbajtur shumica e trupës gjyqese në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të shtesës së pronësisë mbi një sipërfaqe oborri prej 8,7 m<sup>2</sup>, të fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2016. Kjo sipërfaqe oborri, siç rezulton nga hetimi i Komisionit, përfaqëson 3/12 pjesë të një sipërfaqeje oborri në bashkëpronësi me persona të tjerë e që figuron si oborr funksional i banesës së ndodhur në rrugën {\*\*\*}, Tiranë, mbi të cilën gjithashtu subjekti i rivlerësimit ka të drejta bashkëpronësie. Pas blerjes së kësaj pjese, subjekti ka blerë në datën 14.02.2017, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, edhe 3/12 pjesë të truallit nga dy bashkëpronarë të tjerë, duke fituar tashmë në pronësi 1/2 pjesë të këtij trualli. Këtë fakt, pra të dyja këto kontrata dhe të drejtat pasurore mbi këtë sipërfaqe, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2017, duke deklaruar saktë dhe duke ndrequr mosdeklarimin e bërë në deklaratën *vetting*.<sup>9</sup>
33. Referuar vlerës së shitjes së truallit, vlera e pjesës takuese e blerë prej subjektit në vitin 2016 prej 8,7 m<sup>2</sup>, rezulton të ketë qenë 41.142 lekë. Sipas analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, ka rezultuar se subjekti në vitin 2016, kur ka blerë këtë pasuri, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet e këtij viti, kjo për shkak se udhëtimet e shumta të kryera nuk arrijnë të justifikohen me të ardhurat. Në analizë të këtyre rrethanave, vlerësoj se pavarësisht faktit që subjekti nuk ka deklaruar pronësinë mbi sipërfaqen prej 8,7 m<sup>2</sup>, të fituar në vitin 2016 në deklaratën *vetting*, kjo rrethanë nuk duhet të klasifikohet si fshehtësi e pasurisë.
34. Edhe në arritjen e këtij konkluzioni vlen të nënvizoj parashikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon përpjekje për të fshehur pasurinë, përpjekje e cila duhet të justifikohet me një qëllim të caktuar për të manipuluar organet e *vetting*-ut. Pasuria prej 8,7 m<sup>2</sup>,

<sup>9</sup> Referuar kërkimit të bërë në *Open Data* për deklaratat periodike të pasurisë për subjektet e rivlerësimit.

e padeklaruar në deklaratën *vetting*, të krijon bindjen se është një veprim i paqëllimtë i subjektit të rivlerësimit, një harresë apo neglizhencë, e cila nuk mund të barazohet me institutin e fshehjes së pasurisë, së parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, i cili përbën deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

35. Konkluzioni se kemi të bëjmë me një harresë e jo mosdeklarim të qëllimshëm lidhet së pari me vlerën shumë të ulët të kësaj pasurie, vetëm 41.142 lekë, shifër edhe më e ulët se kufiri i shpenzimeve të deklarueshme, të cilat janë mbi 300.000 lekë. Gjithashtu, në këtë konkluzion arrihet edhe duke arsyetuar mbi faktin se vetë subjekti shprehet se e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2017.
36. Gjithashtu, theksoj që pavarësisht se nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, subjekti rezulton të ketë dalë me situatë financiare negative në vitin 2016, e cila është e panjohur për subjektin e rivlerësimit, pasi kjo diferencë negative është konstatuar nga analiza financiare e kryer në Kolegj. Nga aktet nuk rezulton që një diferencë negative të jetë konstatuar edhe në Komision për këtë vit financiar, për pasojë atij nuk i ka kaluar as barra e provës për këtë situatë financiare negative nga Komisioni, në mënyrë që ai të jepte shpjegime për të. Në këto kushte, Kolegji nuk mund të arsyetojë mbi një fakt që rëndon subjektin e rivlerësimit, pa e njohur atë më parë dhe pa i dhënë mundësinë që të mbrohet. Për pasojë, mbetet e paqartë nëse kjo diferencë negative ekzistojë vërtet, në çfarë mase dhe në çfarë konsiston. Në konkluzion, nuk e gjej të drejtë që subjektit t’i atribuohet një mungesë burimi financiar prej 41.142 lekësh të lidhur me këtë pasuri, kur ajo nuk i është adresuar asnjëherë si gjetje nga ana e Komisionit dhe as e Kolegjit. Aq më tepër që vlera e përdorur për të fituar këtë pasuri është lehtësisht e përballueshme prej të ardhurave të ligjshme të subjektit e bashkëshortes së tij për këtë vit financiar. Diferenca negative në këtë vit, në gjykimin tim, nuk i atribuohet blerjes së kësaj pasurie, por shpenzimeve të tjera që ka kryer subjekti për jetesën e tij, për pasojë nuk mund të përdoret si një argument për të mbështetur idenë se subjekti e ka fshehur këtë pasuri, pasi nuk ka pasur mundësi me financa të ligjshme ta blejë atë.
37. Përfundimisht, vlerësoj se edhe kjo pasuri e padeklaruar nuk duhet të klasifikohet si fshehje e pasurisë dhe as si një shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra, në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*